

Dimitrov
Diplomati rus
kishte dalë nga
mandati i tij

Fq.3



**ANKETË
INTEGRIMET**
Bie mbështetja
për Bashkimin
Evropian

Fq.4



Maqedonia
pas zgji-
dhjes së
kontestit
të emrit

Fq.10



Koha

www.koha.mk



Një tjetër
luftë me
Rusinë?

Fq.11

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3328 · e martë 28 mars, 2018

4°C | +14°C

15 DEN

AKTUALE

Teatri
Shqiptar pret
kthimin në
shtëpi



Projekti për rikonstruktimin e Teatrit Shqiptar është në fazën e fundit të realizimit. Edhe pse punimet brenda godinës janë në kulmin e tyre, skelat e ngritura në pjesën më të madhe të objektit, drejtori i këtij institucioni Adem Karaga, ka deklaruar se gjenden pranë përfundimit të këtij projekti. Deklarata e tij është bërë gjatë vizitës së zëvendëskryeministrit Hazbi Lika dhe sekretarit shtetëror të Ministrisë së Kulturës...

Fq.8

RAJON

**Zhvillime
dramatike në
relacionin
Kosovë-Serbi**

Fq.14

DOSSIER

**Planet e
pushtuesit
serb**

Fq.16



JOVEVSKI DREJTON GISHTIN EDHE TE PROKURORËT SHQIPTARË

RIKUALIFIKIMI EDHE ME PËLQIMIN E SHQIPTARËVE



Pa përmendur asnjë emër, kryeprokurori Jovevski dje theksoi se në rikualifikim e kësaj vepre nga "vrasje në aksident trafiku" kanë gisht edhe disa prokurorë shqiptarë. "Nuk është mirë t'i përmendin emrat në konferencë për shtyp", tha mes tjerash Jovevski

Fq.3

Deri të hënën afati për krijimin e shumicës

Tetovë, 27 mars - Këshilli i Komunës së Tetovës ende është i bllokuar dhe jofunksional për shkak të mos krijimit të shumicës. Kështu, kanë ngelur edhe disa ditë, respektivisht deri më 31 mars grupet e këshilltarëve duhet të formojnë shumicën, në të kundërtën - do të duhet të shkohet në zgjedhje vetëm për listat e këshilltarëve. Pas mbajtjes së seancës konstituive dhe miratimit të Buxhetit, Këshilli vetëm një herë

mbajti mbledhje të jashtëzakonshme lidhur me zjarrin që kaploi një shtëpi në Tetovë, ku kishte pesë viktima. Që prej atëherë, Këshilli nuk ka patur asnjë tentim për të mbajtur mbledhje dhe të krijojë shumicën dhe të zgjedh kryetarin, njëkohësisht edhe të formojë komisionet përkatëse. Grupi i këshilltarëve të BDI-së thonë se sa më shpejt që të jetë e mundur do të mbahet një mbledhje...

Fq.9



EDITORIAL

KOSOVËS I NEVOJITET QEVERI E UNITETIT KOMBËTAR



Emin AZEMI

Derisa po shkruhen e thuhet teori të ndryshme konspirative nga njerëz të gjithëdijshëm e gjysëm të dijsëm, rreth prapavijës dhe efekteve që mund të vijnë pas arrestimit dhe dëbimit të Marko Gjuriqit, Kosova ka nevojë ngutshme të formojë një qeveri të unitetit kombëtar. Jo vetëm për të demonstruar pjekuri politike e kombëtare në këto momente dramatike, por edhe për të qenë më të vendosur në kursin e politikave që do ta bënin këtë shtet edhe më kredibil në sytë e opinionit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Nuk do të duhej patjetër të shfrytëzohet dalja e Listës Serbe nga kabineti qeverisës i Haradinajt si pretekst për një format tjetër qeveritar, por kondicioni i mëtejshmë i kësaj qeverie nuk do të mund të mbahej nëse nuk e zgjeron bazën e përfaqësimit me të gjitha partitë parlamentare që janë të interesuara për një të ardhme europiane të Kosovës që do ta bënte më rezistente ndaj aspiratave grabitqare të Serbisë.

Aksioni i të hënës i policisë speciale të Kosovës do të mund të shihej edhe si një adrenalinë publike për të rikthyer moralin e zbehur të shumë njerëzve që ishin skeptikë ndaj aftësive shtetndërtuese të Kosovës, sidomos në shtrirjen e autoritetit dhe sovranitetit në veri të vendit, mirëpo asnjë adrenalinë nuk ka efekt afatgjatë dhe më së paku mund të quhet terapi. E vetmja terapi që aktualisht dhe në të ardhmen mundet ta nxjerrë Kosovën nga kjo atmosferë e ndarjeve të brendshme, si dhe e përplasjeve të mëdha politike, është qeveria e unitetit kombëtar që duhet të tubojë të gjitha ato forca politike që kanë prioritet mbrojtjen e interesave të Kosovës kundruall atyre që po i mohojnë këto interesa, sikundër janë disa eksponentë të serbëve lokalë dhe Beogradi zyrtar. Nëse deri dje ishte Lista Serbe, karemi pas të cilit shumë kush nga politikanët kapej për të shantazhuar kundërshtarin, tani më ky karem, nuk ekziston dhe bashkë me të janë eliminuar edhe arsytet për të ndërtuar e atakuar kauza politike e patriotike.

Ngritja e kapaciteteve vendimmarrëse brenda një qeverie të unitetit kombëtar, nuk do të duhej shikuar vetëm në mikroplan. Kosova jo rastësisht tash e një kohë është përdorur edhe si piketë e hartave të ndryshme gjeopolitike, kurse tash së fundmi ashpërsimi i raporteve në mes të Perëndimit dhe Rusisë, si dhe dëbimi i një funksionari të lartë serbë, përkon me paralajmërimet për një atmosferë të re që Perëndimi refuzon ta quaj - Luftë e Ftohtë.

Kush mund të garantojë që krejt këtë barrë do të mund ta mbartë mbi supet një qeveri pa konsensus të gjerë kombëtar në Kosovë. Aq më tepër, kush mundet të garantojë që aksionet e ardhshme të Beogradit, si në planin diplomatik, ashtu edhe në atë operativ në terren (nuk do të mungojnë provokimet dhe inskenimet e natyrave të ndryshme), do të mund të përballëshin me këtë kondicion elektik e jokoheziv politik të Prishtinës zyrtare.

Shumë kush e ka të qartë se Kosova nuk e ka luksin të provojë rrugë e alternativa të ndryshme që do ta bënin të lumtur pjesën dërmuese të popullatës, mirëpo më pak të lumtur do të ngelin gjithë ata që në njërin anë kërkojnë zgjidhje, kurse në anën tjetër nuk ofrojnë alternativa. Riorganizimi i brendshëm administrativ i Kosovës, përmes Asociacionit të komunave me shumicë serbe, nuk mund të realizohet pa konsensusin e domosdoshëm brendakombëtar dhe ka mjaftuar çështja e Demarkacionit të shërbejë si shembull se deri ku mund të shkojnë polarizimet e brendshme në Kosovë. Kjo e fundit nuk ka më fuqi të përballojë edhe polarizime të tjera. Në vend të kësaj është e udhës t'iu jepet një përgjigje gjithë atyre që Kosovën e duan të ndarë territorialisht dhe të shmangur nga proceset eurintegruese.

JO AVANCIMI I SOVRANITETIT, POR PARAPËRGATITJE PËR NEGOCIATA

"Arrestimi i djeshëm i Marko Gjuriqit ishte i drejtë dhe në përputhje me ligjin. Natyrisht që në Kosovë, sikur në çdo shtet tjetër, duhet të zbatohen masa me të cilat sigurohet integriteti i kufijve dhe territorit. Policia e Republikës së Kosovës dje ishte në nivel të detyrës. Megjithatë shtrirja e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës nuk është çështje aktesh sporadike, por e organizimit serioz e të vendosur shtetëror. Aq më pak është çështje e akteve të mediatizuara. Është pikërisht dimensionin politik i këtij rasti ai që ngrenë shumë pikëpyetje. Arrestimi coincidoi të ndodh në ditën e njëjtë kur Presidenti Thaçi, pas takimeve me Vuçiqin, herë të fshehta e herë publike, e inicoi procedurën e ringjalljes së Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe. Dhe ky aksion policor, gjithnjë duke e kujtuar atë të korrikut të vitit 2011, më shumë se avancimit të sovranitetit i ngjanë parapërgatitjes për negociata. Në këtë drejtim, në vend se të funksionalizohet Republika e Kosovës, rrezikojmë ta funksionalizojmë dialogun e Thaçit, i cili, sikur në të kaluarën, e rrezikon Republikën. Grupi i Deputetëve të Pavarur kërkon që të ndalet përfundimisht avansimi i ndarjes së brendshme në vija etnike, që ka qenë dhe mbetet temë e secilës valë të negociatave. Tash e dhjetë vjet pavarësi, u dëshmuar që këta mekanizma institucional (me predikate etnike) nuk sjellin integritim, por vetëm thellim të ndarjes. Ndarja e brendshme mund të shndërrohet në ndarje formale të Republikës së Kosovës. GDP është i përkushtuar në avancimin e sovranitetit të Republikës dhe karakterit unitar të saj. Republika e Kosovës duhet të jetë Republikë e qytetarëve, të barabartë, bashkëjetues e bashkëpunues", shkruan Visar Ymeri në reagimin për arrestimin e djeshëm të Marko Gjuriqit, në veri të Kosovës.

NËN KANOSJEN E SULMEVE KIBERNETIKE

"Sulmet kibernetike mund të çaktivizojnë faqet zyrtare, rrjetet infrastrukturore, shërbimet themelore, të vjedhin të dhënat e klasifikuara, dhe të dëmtojnë sistemet financiare – dhe shumë mundësi të tjera me pasoja të paparashikuara për sigurinë kombëtare. Në Ballkanin Perëndimor, shtetet në të ardhmen do të përballen me rreziqet kibernetike që mund të vijnë nga Rusia dhe aktorët jo shtetërorë", ka shkruar në profilin e tij në FB studiuesi, Selim Ibrahim.

SKANIMI I PRONAVE NË VIJËN BREGDETARE

"Vendimi i Qeverisë për skanimin e pronave në vijën bregdetare, është një vendim në mbrojtje të interesit publik dhe të interesave të pronarëve të ligjshëm, kundër akteve të shumta kriminale ndaj pronës shtetërore e private. Task Forca e ngritur nga qeveria, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë, do të hedhë dritë mbi abuzimet kriminale me pronën dhe do të ndihmojë në ndëshkimin e abuzuesve të çdo niveli. Dhënia e sipërfaqeve në bregdet, përmes Akteve të Marrjeve në Përdorim të Tokës Bujqësore, është në tërësinë e vet veprimtari korruptive e dënueshme me ligj", ka shkruar në profilin e tij në FB, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

MEDIA Citate

Lista Serbe ka marrë vendim që të dalë nga Qeveria e Kosovës. Këtë vendim e ka kumtuar kryetari i Listës, Goran Rakiq pas takimit që përfaqësuesit e këtij subjekti politik zhvilluan në Beograd me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Njëherësh, Lista Serbe, sipas tij, ka vendosur që gjatë muajit prill të themelojë në mënyrë të njëanshme Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Për këtë hap, ai tha se Lista Serbe ka marrë edhe mbështetjen e Vuçiqit. "Vendimi për tërheqje nga Qeveria e Kosovës është sjellë unanimisht, në mënyrë të përbashkët. Këtë vendim ia kemi thënë sot presidentit Vuçiq dhe ai e ka mbështetur", ka thënë zëvendëskryeministri i Kosovës, Dalibor Jevtiq. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj në një konferencë për media pas një mbledhjes së Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ka deklaruar se veprimet e djeshme të autoriteteve të rendit nuk kanë qenë kundër askujt, në përjashtim të atyre që kanë prishur rendin dhe kanë shkelur ligjet. Haradinaj deklaroi po ashtu se largimi i Listës Serbe, nuk e ka bërë askënd as më të lumtur, as më të hidhëruar. Ai ka thënë se pas këtyre zhvillimeve nuk e ka ndërmend të japë dorëheqje. "Pra, as nuk ka rend të zgjedhjeve as nuk ka rënie të Qeveri, po kjo nuk na bën as më të lumtur as më të zhgënjyer. Unë shpresoj se Lista Serbe të reflektojë sepse veprimet e njëanshme, shkëputja e bashkëpunimit nuk janë zgjidhje. Zgjidhja e vetme është bashkëpunimi, dialogu këto e bëjnë progresin në Kosovë si në jug si në veri. Kam qenë dhe mbetem i përkushtuar për integritimin e gjithë qytetarëve dhe vendit dhe mendoj se kjo është më rendësi", është shprehur Haradinaj. Ai ka thënë se ka marrë përkrahjen e shumë deputetëve, pas largimit të Listës Serbe nga Qeveria e Kosovës. Zëvendëskryeministri Jevtiq ka thënë se Lista Serbe më nuk do të ofrojë mbështetje as në Kuvendin e Kosovës, për iniciativat e Qeverisë. "Pra, në Kuvendin e Kosovës më nuk do t'i mbështesim më vendimet, të cilat janë iniciativa të Qeverisë...", ka thënë Jevtiq. (REL, 27 mars)

NËSE NUK E KENI DITUR...

CILËT JANË KANIONET MË TË NJOHUR NË SHQIPËRI?

Kanionet janë lugina shumë të thella e të ngushta në trajtë grykash, me shpatë të thikta gati pingule, me fund që zakonisht zihet i tëri nga një shtrat lumi ose përroi. Thellësitë e kanioneve mund të shkojnë nga disa dhjetëra në qindra metra. Në Shqipëri kanionet janë shumë të përhapura në të gjithë vendin, kryesisht në viset gëlqerore, por edhe në ato të përbëra nga

shkëmbinj magmatikë. Më të njohurit janë: kanioni i Shoshanit në Valbonë, kanioni i Thethit, kanionet e Osumit, kanionet e Devollit, kanionet e Vjosës dhe degëve të saj, kanioni i Shkopetit (në lumin Mat), kanionet e shumta të Drinit dhe Drinit të Zi etj. Pamje madhështore ka kanioni i Gjipesë, i formuar në përroit me të njëjtin emër në bregdetin e Jonit.

Duke e arsyetuar vendimin për dëbimin e diplomatit rus, Dimitrov tha se bëhet fjalë për person që me veprimet e tij ka dalë jashtë mandatit të tij diplomatik dhe dispozitave të Konventës së Vjenës për marrëdhënie diplomatike

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 27 mars - Vendimin për dëbimin e diplomatit rus nga Maqedonia e morëm pas shqyrtimit dhe analizës së kujdesshme. Vendi bazohet në dy elemente, njëri është ndërkombëtar, gjegjësisht ngjarja që ka ndodhur - helmimi me armë kimike në Britani të Madhe dhe solidaritetin që kanë kërkuar aleatët tanë dhe aksionin e sinkronizuar ku dje ishim dëshmitarë. Kështu deklaroi dje shefi i diplomacisë së Maqedonisë, Nikolla Dimitrov, ndërsa ka informuar se ka edhe bazë vendore për hapin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Siç tha Dimitrov, bëhet fjalë për person që me veprimet e tij ka dalë jashtë mandatit të tij diplomatik dhe dispozitave të Konventës së Vjenës për marrëdhënie diplomatike.

"Ky është reagim që është në funksion të mbrojtjes të interesit shtetëror, të integritetit të institucioneve dhe të sigurisë së shtetit. Dëshirojmë të kemi marrëdhënie miqësore me të gjitha shtetet, të cilat nënkuptojnë sinqeritet dhe mirëkuptim për interesat kyçe dhe

DIMITROV E ARSYETON VENDIMIN PËR DËBIMIN E ZYRTARIT RUS

DIPLOMATI RUS KISHTË DALË NGA MANDATI I TIJ



Lista e vendeve të cilat vendosën t'i bashkëngjiten aksionit të koordinuar global të dëbimit të diplomatëve rusë:

SHBA	-60
Ukraina	-13
Kanadaja	-katër
Polonia	-katër
Franca	-katër
Gjermania	-katër
Lituania	-tre
Çekia	-tre
Holanda	-dy
Danimarka	-dy
Spanja	-dy
Italia	-dy
Estonia	-një
Rumania	-një
Kroacia	-një
Finlanda	-një
Letonia	-një
Suedi	-një
Shqipëria	-dy.

strategjike të të dyja palëve", shtoi Dimitrov. Ai tha se bëhet fjalë për tentim për marrjen e informacioneve të klasifikuara të rëndësishme për sigurinë e Maqedonisë. "Do të ketë shumë interes rreth identitetit të diplomatit. Ne jemi të obliguar ta mbrojmë dhe nga respekti i shtetit të tij Federatës Ruse dhe për shkak të sigurisë personale të personit, kjo

do të jetë shumë e dëmshme nëse spekulohet. Njohuritë tona mbështeten, evidentuar dhe nuk kemi dilema se ka pasur tentime të tilla", tha Dimitrov, duke vlerësuar se midis miqve ka edhe moskuptime, ndërsa kur ata do të tejkalohen miqësia do të jetë më e fuqishme. Deklaratën në fjalë Dimitrovi e dha gjatë takimit me homologen e saj

austriake, Karin Knajnsell, ndërsa kjo e fundit tha shkurt se Austria është prononcuar për solidaritet me Britaninë e Madhe, ndërsa kur bëhet fjalë për dëbimin e diplomatëve - kjo është çështje dypalëshe për vlerësim. "Në kohëra të vështira veçanërisht është me rëndësi t'i lëmë të hapura kanalet për komunikim. Austria ka politikë të neutralitetit, politikë që ndërton ura. Kjo është traditë e diplomacisë austriake, shtoi Knajnsell në pyetjen se Austria nuk ka dëbuar diplomat rus. Ministria e Punëve të Jashtme të hënën mbrëma kumtoi se dëbon një diplomat të Federatës Ruse, për shkak të rastit Skripal. Vendimi i MPJ-së të Maqedonisë është marrë pas konsultimeve me aleatët dhe partnerët nga BE-ja dhe NATO-ja. Ambasada ruse mbrëmë në Twitter publikoi se Maqedonia do t'i bartë pasojat nga dëbimi i diplomatit rus.

IVANOV: I PËRSHPEJTUAR DËBIMI I DIPLOMATIT RUS

Republika e Maqedonisë si vend kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, e ndjekë politikën e BE-së dhe vendimet e tyre të sjellura me anë të konsensusit dhe në nivel të BE-së. Duke marrë parasysh atë se vendimet për dëbim të diplomatëve rusë nuk paraqet shprehje të qëndrimeve të harmonizuara të të gjitha vendeve-anëtare të BE-së, por bëhet fjalë për vendime individuale të vendeve-anëtare individuale, presidenti i RM-së konsideron se vendimi i MPJ-së së Maqedonisë është i përshpejtuar. Kjo ceket në qëndrimin nga Kabineti i presidentit



Gjorge Ivanov lidhur me vendimin e MPJ-së për dëbim të diplomatit rus. "Presidenti i Republikës së Maqedonisë bën thirrje për përmbytshmëri nga hapat e përshpejtuar në politikën e jashtme, në mënyrë që të parandalohet shkaktimi i mundshëm i dëmit në realizimin e qëllimeve strategjike të Republikës së Maqedonisë", ceket në qëndrimin e Kabinetit presidencial. Shtohet se presidenti i RM-së, në pajtim me rregullativën pozitive ligjore, pret të informohet zyrtarisht për faktet e cekura në opinion, lidhur me këtë rast.

Pa nënshkrimin e Ivanovit, Ligji i shqipes nuk mund të shpallet!

Shkup, 27 mars - Në Kushtetutë ekziston dispozitë e qartë e pakushtëzuar, e cila e obligon presidentin e Republikës në situata kur Ligji për herë të dytë miratohet me shumicë absolute, me mbi 61 vota, është i obliguar ta dekretojë Ligjin për shpalljen e tij. Kjo dispozitë nuk paraqet kurrfarë bazash, kush-tesh që presidenti t'i vlerësojë. Thjesht, ai është i obliguar ta bëjë këtë. Kështu deklaroi ish-gjykatësi në Gjykatës Kushtetuese, Igor Spirovski, sipas të cilit, Ligji është miratuar sepse është miratuar nga Parlamenti, ndërsa kjo që mungon është shpallja dhe publikimi i tij në "Gazetën Zyrtare", ndërsa një pjesë të asaj përgjegjësie sipas Kushtetutës e ky edhe presidenti i shtetit i cili nuk dëshiron ta zbatojë.

"Mendoj se askush nuk mundet ta zëvendësojë nënshkrimin e presidentit të Republikës në dekretin", tha Spirovski dhe shtoi se në praktikë të Gjykatës Kushtetuese, në atë kohë kishte një rast të tillë. Kjo do të thotë, theksoi Spirovski, se pa nënshkrimin e tij, Ligji nuk mund të shpallet dhe të hyjë në fuqi edhe pse është miratuar. Atë që presidenti tregon se ka arsye të veta, thotë Spirovski, nga pikëpamja e Kushtetutës është jorelevante. Në pyetjen çfarë do të ndodhë nëse presidenti nuk e dekreton, Spirovski u përgjigj se juridikisht mbesin opsionet për impleçment, pavarësisht asaj nëse ka apo nuk ka shumicë për këtë në Parlament.

Bakojani nuk beson në marrëveshje për emrin

Athinë, 27 prill - Pesimizëm në raport të mundësisë për zgjidhje të kontestit të emrit shprehu ish-shefja e diplomacisë greke, ndërsa tani deputete e Demokracisë së Re, Dora Bakojani. Në intervistë për radion "Tema" ajo e komenton edhe deklaratën e djeshme të liderit të Grekëve të Pavarur. "Kamenos nuk do të bëjë asgjë. Ai është i ngjitur për kolltukun, as në ëndërr nuk mundet ta shihet se do të vinë dikush ta bëjë ministër të Mbrojtjes. Shumë të rënda më duken punët për zgjidhje, nuk e kam ndjenjën se po shkojmë drejt

marrëveshjes", thotë Bakojani. Këto pozita të saj, "se është e bllokuar puna dhe është shumë rëndë të ekzistojë marrëveshje", i mbështet me qëndrimin se Qeveria greke gabimisht i ka udhëhequr negociatat nga vetë fillimi në raport të esencës. "Kur themi një erga omnes emër mendojmë në emër që do të jetë për të gjithë edhe brenda edhe jashtë edhe në aspekt bilateral dhe multilateral etj. Vetëm ashtu mund të zgjidhet problemi. Ta ndërrojmë FYROM përkatësisht Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ta quajmë

më ndryshe, ndërsa ai emër të përdoret siç përdoret edhe FYROM, ajo nuk është zgjidhje. Nuk ndalet irredentizmi. Erga omnes ka peshë të veçantë, e ka peshën më të madhe nga të tjerat. Kur këtë çështje me Kushtetutën e fut 2,5 muaj pas fillimit të negociatave, diçka nuk është në rregull", sqaron deputetja e partisë opozitare greke Demokracia e Re. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, Bakojani thotë se më e keqja në tërë rastin është ajo që "në këtë moment punohet në ditën e ardhshme, përkatësisht në atë që quhet

"blame game"- e cila do ta paguajë mossuksesin e negociatave". Ajo situatën e tanishme e krahason me atë prej para 10 viteve në samitin e NATO-s kur pikërisht ajo ishte ministre e Punëve të Jashtme të Greqisë. Thotë se atëherë vendi ka arritur të ketë shtatë kryeministra të palës greke, ndërsa mossuksesi të mos jetë në barë të Athinës. "Sot nuk jam aspak e sigurt se cili do të jetë rezultati dhe kush do ta paguajë fiaskon në negociatat", shton Bakojani në intervistë për radion, transmetoi MIA. Në pyetjen për inkuadrimit eventual të vendit



tonë nën referencë të përkohshme, ish-shefja e diplomacisë greke thotë se pikërisht për atë ka qenë presioni në vitin 2008, përderisa ndodh ajo tani, atëherë Greqia nuk do të ketë kurrfarë vegle për presion ndaj Shkupit".

MEGJITHËSE 73 PËR QIND E QYTETARËVE JANË PËR HYRJE NË UNION

BIE MBËSHTETJA PËR BE-në



Vetëm një e treta e popullatës në Maqedoni do ta mbështesë anëtarësimin në BE, nëse kjo do të kushtëzohej me ndryshimin e emrit të shtetit, ndërsa 45 për qind e popullatës e mbështesin anëtarësimin në BE, por vetëm nën emrin kushtetues

Koha

Evis HALILI

Shkup, 27 mars - Mbështetja për hyrje në Bashkimin Evropian është në rënie të vazhdueshme në dhjetë vitet e fundit, por megjithatë ajo edhe më tej është e lartë, duke pasur parasysh atë që 73 për qind e qytetarëve të Maqedonisë janë për hyrje të vendit në Union. Këto janë rezultatet nga analiza krahasuese e mendimit publik për procesin e Maqedonisë të inkuadrimin drejt BE-së (2014-2017), të përpiluar nga Societe Civilis - Shkup dhe Konrad Adenauer Stiftung. Autori i analizës, Ivan Damjanovski, gjatë prezantimit të saj, theksoi se mbështetja është në rënie të vazhdueshme, respektivisht prej 80 për qind në vitin 2015, nga fundi i vitit 2017 zbrit në 73 për qind. Shton se numri i të anketuarve euroskeptikë mbetet afërsisht i njëjtë, rreth 17 për qind. Duke pasur parasysh atë që numri i kundërshtarëve për anëtarësim nuk ka ndryshuar mes dy hulumtimeve të fundit, rënia manifestohet përmes rritjes së numrit të të anketuarve, të cilët janë të pavendosur.

Rezultatet nga anketa e vitit 2017 tregojnë se 73 për qind e qytetarëve do të votonin "pro" nëse javën e ardhshme mbahet referendum për hyrje të Maqedonisë në BE. Shtatëdhjetë për qind do të votonin kundër, tetë për qind janë përgjigjur "nuk e di", ndërsa një për qind nuk do të votojnë. Analiza krahasuese është përpiluar në bazë të rezultateve nga tre anketa, të zbatuara në vitin 2014, 2016, ndërsa fokusi është tek ajo në vitin 2017, që u zbatua në ekzemplar prej 1100 të anketuarve.

Implikime identiteti, të cilat dalin nga kontesti me Greqinë rreth përdorimit të emrit Maqedoni,

imponohen si shkak kryesor për rënien e mbështetjes për anëtarësim në Union në dhjetë vitet e kaluara. Damjanovski shtoi se rënie graduale koïncidon me imponimin e zgjidhjes së kontestit rreth emrit si kusht kryesor për progres në procesin e Maqedonisë të inkuadrimin drejt Unionit. Vetëm një e treta e popullatës në Maqedoni do ta mbështesë anëtarësimin në BE, nëse kjo do të kushtëzohej me ndryshimin e emrit të shtetit, ndërsa 45 për qind e popullatës e mbështesin anëtarësimin në BE, por vetëm nën emrin kushtetues. Shtatëdhjetë e shtatë për qind e të anketuarve në vitin 2017 e mendojnë veten si jashtëzakonisht maqedonas, shqiptarë ose pjesëtarë të komuniteteve të tjera etnike, ndërsa vetëm tre për qind konsiderohen si evropianë. "Përsëmbëdhjetë vitet e fundit ka korrelacion të qartë midis trendeve të mbështetjes me kredibilitetin e perspektivës së Maqedonisë me anëtarësimin në BE", thotë Damjanovski. Ai sqaroi se mbështetja më e lartë është në periudhën nga viti



Në lidhje me ndikimin partiak ndaj mbështetjes për hyrje në Union, simpatizantët e BDI-së japin mbështetje më të madhe e cila arrin 90 për qind, LSDM-ja është në vendin e dytë me 83 për qind, ndërsa VMRO-DPMNE-ja është me 60 për qind mbështetje

2004 deri në vitin 2009, kur Maqedonia e përforcoi pozitën e saj në procesin inkuadruar përmes marrjes së statusit kandidat dhe rekomandimit për fillimin e negociatave për anëtarësim.

Në pyetjen se cila është arsyeja kryesore për të cilën Maqedonia ende nuk është pjesë e Unionit, 37 për qind mendojnë se ajo është mos realizimi i reformave të

brendshme, ndërsa përqindja e njëjtë mendojnë se vendet fqinje e pengojnë hyrjen e Maqedonisë në BE. Te arsyeja e dytë shihet ulje në vitin 2017, ndërsa në vitin 2016 mendim të tillë kanë pasur 47 për qind, ndërsa në vitin 2014, 59 për qind. 27 për qind e të anketuarve në sondazhin e vitit 2017 mendojnë se Maqedonia në tre vitet e ardhshme do të bëhet anëtare e Unionit, 22 për qind në pesë vitet e ardhshme, 20 për qind mendojnë se kjo nuk do të ndodhë asnjëherë, 12 për qind janë përgjigjur se pjesë e BE-së do të bëhemi në dhjetë vitet e ardhshme, 11 për qind nuk e dinë, ndërsa shtatë për qind mendojnë se kjo do të ndodhë në 20 vitet e ardhshme. 51 për qind e të anketuarve mbështetjen e tyre për hyrje në BE do ta japin për shkak të avancimit të standardit jetësor, ndërsa 23 për qind për shkak të uljes së papunësisë. Dymbëdhjetë për qind mendojnë se kështu do të rritet siguria dhe stabiliteti i shtetit, ndërsa pesë për qind se do të mundësohet qasje për punë jashtë vendit.

SHQIPTARËT PËR AMERIKËN

SHBA-ja është faktori më me ndikim i jashtëm në Maqedoni, Bashkimi Evropian është në vendin e dytë, e treta është Rusia. Këto janë rezultatet nga analiza "Bashkimi Evropian në prag të kthimit në Republikën e Maqedonisë", të përpunuar nga Instituti për demokraci, Societas civilis - Shkup dhe Konrad Adenauer Stiftung, që sot u prezantua nga autorët, Zoran Neçev dhe Nenad Markoviq. Përfshirje më të madhe të BE-së në ngjarjet politike në vend dhe reformat në periudhën e krizës e ka rritur kredibilitetin e Unionit mes qytetarëve të Maqedonisë, ndërsa e tërë kjo ka rezultuar me rënie të perceptimit të ndikimit rus, thonë autorët. Analiza, e cila është e përpunuar në bazë të anketës telefonike të IDSCS, e zbatuar në dhjetor të vitit 2017 në ekzemplarë prej 1100 të anketuarve, tregon se 41 për qind vlerësojnë se

SHBA-ja është faktori më me ndikim i jashtëm. Neçev theksoi se derisa në vitin 2016, 21,8 për qind nga të anketuarit shikojnë në BE si faktor më me ndikim të jashtëm, një vit më vonë 38,1 për qind e kanë këtë mendim. Ai shtoi se 6.2 për qind nga të anketuarit e perceptojnë Rusinë si faktor më me ndikim të jashtëm në vitin 2016, ndërsa vitin e kaluar vetëm 3.7 për qind e kanë perceptimin e njëjtë. Kur hulumtohet përkatësia etnike, maqedonasit etnikë e perceptojnë SHBA-në si faktor më me ndikim të jashtëm (43.5 për qind), pas tyre janë BE-ja me 34 për qind dhe Rusia me 3.6 për qind. Tendencë mes shqiptarëve etnik që ta perceptojnë BE-në si fuqi më me ndikim mbetet e njëjtë sikur edhe në vitin 2016 (53.4 për qind), pas çka vijojnë SHBA-ja (34.4 për qind) dhe Rusia (4.5 për qind).

Edhe një padi për Talevskin

Manastir, 27 mars - Sektori për punë të brendshme Manastir në Prokurorinë themelore publike Manastir ka ngritur kallëzim penal kundër ish-kryetarit të Manastirit, Vladimir Talevski (59) për vepër të kryer penale "Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve". Kallëzime penale, njëjto në konferencë për shtyp SPB Sanja Stamatova janë parashtruar edhe kundër tre bashkëpunëtorëve të tij të dyshuar për "Punë jo koshiente në detyrë": S.B. (59) ish-drejtuës i financave dhe kryetar i komisionit për furnizime publike, M.K. (66) jurist në Komunën e Manastirit dhe anëtar i Komisionit për furnizime publike dhe S.P. (55), këshilltar për arsim në komunën e Manastirit dhe anëtar i Komisionit për furnizime publike.

Të ruhet çmimi i tanishëm i lakrës

Shkup, 27 mars - Në dy javët në vijim të ruhet çmimi blerës i lakrës pranverore në 30 denarët e tanishëm në mënyrë që të mbulohen shpenzimet dhe prodhimi të jetë rentabil, kërkuar bujqit në takimin e sotëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU). Sipas tyre, çdo ditë duhet të ndiqen çmimet blerëse të lakrës në tregjet e huaja, në mënyrë që të bëhen analiza, e më pas bashkërisht me blerësit të kontraktuar çmimi blerës në interes të të dyja palëve. Lakra pranverore për momentin eksportohet në Rusi, Poloni, Rumani, Bjellorusi dhe Ukrainë. Interesi për blerje është i madh, për çshkak nuk pritet tepëricë. Në takim, këshilltarja e posaçme e kryeministrit për Bujqësi, Lençe Nikolloska, tha se gjendja po ndiqet në mënyrë të vazhdueshme, por paralelisht po punohet edhe në strategjinë afatgjate për sigurimin e plasmanit të sigurt dhe në krijimin e prodhimtarisë së fuqishme kontraktuese mes bujqve dhe blerësve. Në mënyrë që të ruhet çmimi blerës i lakrës në nivel të kënaqshëm, këto ditë do të mbahet takim edhe me blerësit e lakrës pranverore. Takimi në MBPEU me prodhuesit u mbajt një ditë pas protestës paralajmëruese që u mbajt në Murtino.

Pa përmendur asnjë emër, kryeprokurori Jovevski dje theksoi se në rikualifikim e kësaj veprë nga "vrasje në aksident trafiku" kanë gisht edhe disa prokurorë shqiptarë. "Nuk është mirë t'i përmendim emrat në konferencë për shtyp", tha mes tjerash Jovevski

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 27 mars - Rikualifikimi i veprës vrasje me paramendim në "aksident trafiku" për rastin e 4-vjeçarit Almir Aliu, është bërë edhe me pëlqimin e disa prokurorëve shqiptarë. Kështu tha dje para gazetarëve kryeprokurori Lubomir Jovevski duke u përgjigjur në pyetjen e gazetës KOHA, se a është i shqetësuar nga fakti se mbi rastin e Almir, Prokuroria është ndarë në baza etnike. Shqiptarët që punojnë aty thonë se vepra është "vrasje me paramendim", ndërsa për kolegët e tyre maqedonas kjo është "aksident trafiku".

"Nuk është i saktë konstatimi se prokurorët në rastin e Almir, deri në fund janë të ndarë në bazë etnike. Për rikualifikimin e aktakuzës në rastin e Almir, kanë votuar edhe prokurorë që i përkasin përkatësisë etnike shqiptare. Mendoj se kjo është çështje e Kolegjiut të prokurorëve, dhe nuk është mirë t'i përmendim emrat në konferencë për shtyp", tha dje prokurori Jovevski, i cili nuk dëshiroi të ofrojë detaje mbi atë se kush dhe çfarë qëndrimi ka mbajtur, duke ritheksuar, sipas tij, se vendimi nuk është mbështetur në baza etnike.

JOVEVSKI DREJTON GISHTIN EDHE TE PROKURORËT SHQIPTARË PËR RASTIN E ALMIRIT



RIKUALIFIKIMI EDHE ME PËLQIMIN E SHQIPTARËVE

Nga ana tjetër, gazeta KOHA dhjetë ditë me radhë është duke pritur përgjigje zyrtare nga Prokuroria mbi kërkesën tonë që të njihemi me procesverbalet nga ajo mbledhje ku është vendosur fati i aktakuzës kundër Boban Iliqit. Përgjigje ende s'kemi marrë edhe pse jozyrtarisht mësojmë se ato procesverbale ende nuk janë miratuar nga prokurorët. Afati ligjor për respektimin e obligimit për komunikim me opinionin është 30 ditë, dmth kanë mbetur edhe 20 ditë për të marrë përgjigje nga prokuroria mbi këtë çështje.

Qëndrimin e tij të njohur për mbrojtjen e vrasësit Boban Iliq, kryeprokurori Jovevski e përsëriti edhe të martën. Sipas tij, rikuali-

fikimi i aktakuzës në rastin e Almir është realizuar pasi ata kanë qenë më se të sigurt se nëse qëndron aktakuza e parë, Gjykata në këtë rast do të shqiptonte aktgjykim të lirë për të akuzuarin. Mes tjerash, prokurori reformues i Prokurorisë Republikane, Lubomir Jovevski, i cili sipas shumicës së opinionit vazhdon t'i ndjek hapat e ish shefit të tij Marko Zverlevski, të martën foli edhe për fatin e katër kolegëve të tij shqiptar. Dilemën e parashtruar nga gazeta KOHA, se Këshilli për Etikë pranë Prokurorisë Republikane pritet t'i shkarkojë nga detyra prokurorët Ismail Dardhishta, Xhelal Bajrami, Bashkim Besimi e Ferat Elezi, kryeprokurori Jovevski e demantoi s'i të pavërtetë.

"Nuk e di se nga i keni informacionet se prokurorët shqiptarë do të jenë të përjashtuar. Një procedurë e tillë aspak nuk është iniciuar. Për momentin bëhet fjalë se vallë, prokurorët shqiptarë a e kanë shkelur Kodeksin e prokurorëve publik ose jo. Kjo është punë e Këshillit për Etikë, se vallë do të inicioj procedurë ose jo, unë nuk e di", tha Jovevski.

Protestat masive kundër rikualifikimit të aktakuzës, në rastin e Almir, për shefin e ri të Prokurorisë Republikane, Lubomir Jovevski, nuk paraqesin ndonjë domethënie të madhe. Kërkesën për dorëheqje të parashtruar javën e kaluar nga protestuesit, kryeprokurori Jovevski as që e ka përfilur, më së paku ta ketë komentuar.

Këmbëngulja se rikualifikimi i aktakuzës kundër vrasësit Boban Iliq, është një vendim ligjor dhe i drejtë, vazhdon të mbështet nga ai, përkundër faktit se zyra e Avokatit të Popullit, ka regjistruar një varg parregullsish sa i përket mënyrës se si prokuroria Suzana Kusigerska e ka zhvilluar tërë lëndën.

Seanca gjyqësore e radhës me fjalët përfundimtare të avokatëve të familjes Aliut, pritet të zhvillohet me datën 2 prill. Kështu që mbetet të shihet se vallë Gjykata e Kumanovës, do ta pranojë kërkesën për rikualifikim të veprës, ose aktgjykimin e saj kundër vrasësit Boban Iliq, do ta mbështesë në veprën penale "aksident me pasojë vdekje".

PËRFUNDUAN HETIMET PËR NATËN E PËRGJAKSHMENË PARLAMENT

MBI 30 TË AKUZUAR PËR 27 PRILLIN

Shkup, 27 mars - Prokuroria për krim të organizuar, të martën deri te Gjykata Penale e Shkupit, e ka parashtruar aktakuzën për ngjarjet e 27 prillit në Parlament, kundër 30 personave. Të akuzuarit, gjithsej 35, prej të cilëve për momentin vetëm 30 janë të kapshëm për organet e rendit, siç thuhet në aktakuzë - ngarkohen për veprën penale "terrorizëm", respektivisht dy nga tridhjetë të akuzuarit ngarkohen për dhënien ndihmë të dyshuarve për terrorizëm. Procedurë hetimore e zhvilluar nga Prokuroria për krim të organizuar para dhe pas 28 nëntorit të këtij viti, ka konstatuar se deputetja nga radhët e VMRO-DPMNE-së, Zhaklina Peshevska, nuk ka lidhje me ngjarjet e 27 prilli të vi-

tit të kaluar. "Kemi siguruar prova se të akuzuarit kanë kryer më shumë veprime, duke filluar nga mobilizimi i anëtarësisë së shoqatave dhe personave tjerë, me të vetmin qëllim futjen e dhunshme në Parlament dhe kryerjen e dhunës brenda këtij institucioni shtetëror", tha zëdhënësjja e Prokurorisë Publike, Elizabeta Nedanovska. Përshkrimi detajesh të vogla nga aktakuza për ngjarjet e 27 prillit, nxori në pah se tre funksionarë të lartë të MPB-së, mes tyre edhe ish-ministri, Mitko Çavkov, përkundër faktit se vazhdimisht kanë qenë të informuar se deputetët janë të rrezikuar me jetë, përfshirë gazetarët dhe persona tjerë të punësuar në Parlament, ata nuk kanë dhënë urdhër për in-

tervenimin e policisë. Tre funksionarët e lartë të MPB-së, nën akuzën për "terrorizëm", thuhet se nuk kanë dhënë urdhër për shtimin e forcave speciale policore, për evakuimin e të rrezikuarve dhe në këtë mënyrë - ata kanë kontribuar që turma e njerëzve të futet në Parlament dhe kështu ta realizoj sulmin e dhunshëm.

Dy funksionarët e lartë të MPB-së, ndryshe nëpunës të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, akuzon si ndihmës të veprës "terrorizëm", me arsyetim se të njëjtit pas ngjarjeve të dhunshme nga zyra të caktuara në Parlament, kanë marrë dy hard disk me materiale nga xhirimet e kamerave të sigurisë, me të vetmin qëllim mbulimin e gjurmëve dhe mos regjistrimin e



veprimeve të dhunshme datën e 27 prillit. Në këto ngjarje, sipas Prokurorisë, kanë qenë të përfshirë edhe persona të panjohur, për të cilët u paralajmërua iniciimi i masave hetuese shtesë.

Ndryshe, Gjykata Supreme të hënën e pranoi propozimin e palës mbrojtëse të një pjesë të të akuzuarve për ngjarjet e 27 prillit dhe në këtë mënyrë masat e paraburgimit ndaj Mitko Çavkovit, deputetëve Kërste Mukovski dhe Sasho Va-

silevski, i zëvendësoi me paraburgim shtëpiak. Këta deputet dhe funksionarë të VMRO-së, për tre muaj rresht qëndruan në burgun e Shutkës, me çka në disa raste Gjykata e Apelit ua vazhdonte masën e paraburgimit. Masat e paraburgimit shtëpia, Gjykata Supreme e Maqedonisë, po ashtu ua shqiptoi edhe pjesëtarëve të MPB-së, Mitko Peshev, Dushko L Lazarov, Goran Gjoshevski, Oliver Popovski dhe Munir Pepiq. (O.Xh)

KRONIKË

Paditet shkupjani,
e vrau nënën e tij

Policia parashtrori padi penale kundër shkupjanit M.G. (50), i dyshuar për vrasje të nënës së tij më 19 mars. Ai në mbrëmje rreth orës 19 në shtëpinë familjare ka vendosur së pari t'ia marrë jetën nënës së tij K.G. (77), ndërsa pastaj të bëjë edhe vetëvrasje. Derisa nëna e tij ka qenë në krevat, M.G. i ka shkakuar plagë në pjesën e gjoksit dhe gjatë natës disa herë është munduar të bëjë vetëvrasje, por nuk ia ka arritur qëllimit. M.G. edhe në ditët në vijim, disa herë është munduar të bëjë vetëvrasje, por nuk ka arritur dhe ka hequr dorë nga qëllimi dhe ka vendosur të mbetet në shtëpinë e tij. Në datën 24 të këtij muaji, rreth orës 20, në shtëpi ka arritur vëllai i të paraqiturit, i cili e ka gjetur nënën e vdekur, ndërsa i denoncuar ka thënë se ai e ka vrarë. M.G. është privuar nga liria dhe pas bisedës së kryer me të, e sqaroi mënyrën e kryerjes së veprës. Pas urdhrorit të Prokurorit publik trupi i të vdekurës është dorëzuar për autopsi.

Dy turq arrestohen
në dy pika kufitare

Në dy pika kufitare në Maqedoni mbrëmë janë arrestuar dy shtetas të Turqisë. Njëri në pikën kufitare "Dellçevë" për shkak të dyshimit për falsifikim të kartonit të gjelbër për auto siguri, ndërsa tjetri në "Deve bair" për shkak të dyshimit se ilegalisht ka hyrë në Maqedoni. "Mbrëmë në orën 10:30 në PK "Dellçevë" në hyrje të Maqedonisë për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim për falsifikim të kartonit të gjelbër ndërkombëtar për sigurim nga autopërgjegjësia, ishte privuar nga liria shtetasi turk B.S. (44), i cili kishte drejtuar automjetin "Reno" me tabela kombëtare turke. I njëjti ishte dorëzuar para autoriteteve policore në Stacionin policor për procedurë të mëturjeshe, informojnë nga MPB. Në lidhje me rastin e dytë nga atje kumtojnë se ka ndodhur mbrëmë në orën 21:00 në PK "Deve bair" kur në dalje të Maqedonisë për shkak të ekzistimit të bazave të dyshimeve se ka hyrë ilegalisht në Republikën e Maqedonisë (nuk ka pasur vulë për hyrje në RM në dokumentin e udhëtimit dhe nuk ishte evidentuar), ishte arrestuar shtetasi turk O.A. (38). Ai ishte dorëzuar para autoriteteve policore nga Stacioni policor Kriva Palanka për procedurën e mëtejme.

Shkup, 9 aksidente për 24 orë

Një këmbësor ka marrë lëndime të rënda nga gjithsej nëntë aksidente të regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin SPB të Shkupit. Në tre aksidente lëndime të lehta kanë marrë gjashtë persona, ndërsa në pesë është shkakuar dëm material. Siç informojnë nga MPB, gjatë ditës së djeshme policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Njëzet shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, tetë persona kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, dy shoferë nuk kanë dhënë përparësi për kalimin e këmbësorëve në vendkalim për këmbësorë, dy shoferë janë renditur në mënyrë të parregullt dhe dy shoferë për parakalim të parregullt. Nga trafiku janë sanksionuar dy shoferë për shkak të drejtimit të automjetit në ndikim të alkoolit, 25 të tjerë janë përjashtuar nga trafiku para se ta marrin të drejtën për drejtimit të automjetit, dy shoferë fillestarë, si dhe dy kanë drejtuar automjetin teknikisht të parregullt, 20 automjete të paregjistruara dhe një automjet për stërngarkim. Janë hasur edhe 195 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 90 automjete. (O.Xh)

ANALIZË E RE PËR TRANSPARENCËN DHE PËRGJEGJËSINË E GJYKATËSVE

KËSHILLI GJYQËSOR KA
DËSHTUAR NË TRANSPARENCË

"Transparenca e Këshillit Gjyqësor është më shumë formale se sa thelbësore", deklaroi kryetarja e Institutit për të Drejtat e Njeriut, Margarita Caca Nikolovska

Shkup, 27 mars - Transparenca, përgjegjësia dhe efektiviteti të cilat ishin lëndë e monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor të Maqedonisë nuk janë në nivel të kënaqshëm, edhe pse në periudhën më të vonshme të monitorimit u pa përparim në implementimin e këtyre standardeve. Kjo është e bërë e ditur në përfundimet dhe rekomandimet nga Analiza për transparencë, përgjegjësi dhe efektivitetin e punës së Këshillit Gjyqësor, si dhe përfundimet nga raporti i pestë tremujor për punën e Këshillit Gjyqësor për periudhën e dhjetorit të vitit 2017 deri në mars të vitit 2018 të Institutit për të Drejtat e Njeriut.

"Transparenca e Këshillit Gjyqësor është më shumë formale se sa thelbësore", deklaroi kryetarja e Institutit për të Drejtat e Njeriut, Margarita Caca Nikolovska para mbajtjes së konferencës përfundimtare dhe diskutimit në temën "Çfarë Këshilli Gjyqësor i nevojitet shoqërisë në Maqedoni?". Sipas saj, është e nevojshme të mundësohet transparencë thelbësore mes të tjerash edhe përmes gazetareve.

"Komunikimi me publikun, i cili mund të realizohet edhe përmes gazetareve, të jetë thelbësor, që të mundet opinioni në mënyrë përkatëse ta vlerësojë punën e Këshillit Gjyqësor", tha Caca Nikolovska. Ajo theksoi se moszgjidhja, pa shpjegim të kryetarëve të Gjykatave, të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit në Shkup dhe në Gjykatën Supreme të RM-së nga kandidatët e paraqitur në konkurset e publikuara, është reflektim i punës joefikase dhe joefektive të Këshillit Gjyqësor. Në konte-



st të kësaj, Caca Nikolovska shtoi se kjo edhe më shumë shihet nga ajo se menjëherë pastaj publikohet konkurs për plotësim të vendeve të njëjta. Gjykatësja e Gjykatës Supreme të RM-së në pension, Vera Koco vlerësoi se në periudhën e kaluar Këshilli Gjyqësor nuk ishte në nivelin që pritej nga opinioni dhe qytetarët e Maqedonisë. "Kjo ishte arsye për humbjen e besimit në organin më të lartë të pavarur gjyqësor që duhet të mundësojë dhe garantojë pushtet gjyqësor autonom dhe të pavarur", tha Koco. Ajo theksoi se Këshilli Gjyqësor më së shumti dështoi në transparencë, efikasitetin, efektivitetin dhe se përbërja e tillë e Këshillit kërkon reforma. Ish-gjykatësi i Gjykatës Kushtetuese, Igor Spirovski, mes të tjerash tha se anëtarët e Këshillit Gjyqësor kanë problem me kredibilitetin, para se gjithash me joaktivitetin në lidhje me raportin e sistemit të lëndëve në AKMIS. "Raporti i Komisionit të Ministrisë së Drejtësisë tani është në rend të ditës të Këshillit Gjyqësor dhe çështja është se çka do të bëjë ai, nëse tani konfirmohet përgjegjësia e kryetarëve të gjykatave dhe gjykatësve për manipulime me AKMIS-in dhe si ajo mund ta bëjë atë kur është pjesë e krijimit të atij problemi", tha Spirovski. Kryetari i Këshillit Gjyqësor, Zoran Karaxhovski, tha se

nuk pajtohet me kritikën e nxjerra në përfundimet për punën e Këshillit Gjyqësor. "Duhet të bëhet analizë krahasuese dhe të shihet se cili Këshill gjyqësor në Evropë është më transparent dhe atëherë do të bisedojmë se në cilin vend është Këshilli Gjyqësor i RM-së në lidhje me transparencën", tha Karaxhovski. Në kontekst të asaj shtoi se nga analizat krahasuese që personalisht i ka bërë, Karaxhovski tha se Këshilli Gjyqësor i RM-së gjendet në një nga vendet më të larta, ndërsa pjesa më e madhe e Këshillave të tjerë gjyqësor janë shumë pak transparentë ose nuk janë aspak transparentë. Ambasadori britanik Çarls Garet potencoi se qeverisja e të drejtës është bazë e gjithçkaje që e bën një shoqëri, stabile, korrekte dhe prosperuese. Ajo, tha Garet, është bazë për sigurinë tonë dhe për rendin e saktë të themeluar të rregullave ndërkombëtare pa të cilin bota do të ishte më e pasigurt dhe më e rrezikuar. "E vërteta është se të gjithë gjykatësit, prokurorët, avokatët...e dinë çka është ajo që duhet ta bëjnë. Për atë duhet të inkurajohen ta bëjnë atë. Duhet t'u gjenden mjete se si ta bëjnë atë me qëllim që të mundën të japin rezistencë të presionit jolegjitim. E njëjta vlen për tërë sektorin publik", theksoi ambasadori Garet.

"TARGET-FORTESA" SHTYHET PËR MË 15 MAJ

Shkup, 27 mars - Debati publik për lëndën "Target-Fortesa" të PSP-së është shtyrë për më 15 maj për shkak të procedurës së pakryer për ekstradim që udhëhiqet para Gjykatës Supreme në Greqi për të dy të akuzuarit Goran Grujevski dhe Nikolla Boshkovski. Gjykata paralajmëroi se do të shqyrtohet mundësia për ndarjen e procedurës nëse deri në debatin e ardhshëm ata nuk ekstradohen. Mbrojtja në seancën e djeshme tha se Grujevski dhe Boshkovski nuk janë të pakapshëm për gjykatën, por se nuk kanë mundësi të vijnë sepse në Greqi udhëhiqet procedurë për ekstradim. Procedura, siç theksuan, është në fazën e ankesës dhe për të duhet të vendosë Gjykata Supreme e Greqisë më 27 prill. Në lëndën janë të akuzuar ish-shefi i



Drejtorisë së Pestë në MPB Goran Grujevski dhe i punësuar në DSK Nikola Boshkovski, të cilët janë në paraburgim në Greqi, ish-ministrja e MPB-së Gordana Jankullovska, ish-drejtori i DSK-së Sasho Mijallovski dhe shefi i kabinetit

të Mijallovski, Toni Jakimovski. Hetimi për lëndën "Fortesa" ishte hapur më 29 mars të vitit 2016, ndërsa për lëndën "Target" më 17 nëntor të vitit 2016, ndërsa për shkak të lidhshmërisë së tyre janë bashkuar në një lëndë. Akuza është ngritur më 30 qershor të vitit 2017. Sipas aktakuzës, përmes tre sistemeve për ndjekjen e komunikimeve në DSK, në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2015 në mënyrë të paligjshme janë ndjekur 4.286 numra telefonikë për të cilat aspak nuk janë lëshuar urdhra gjyqësorë. Komunikimi ishte ndjekur para se të lëshohet edhe pas përfundimit të kohëzgjatje së vlefshmërisë së urdhrave gjyqësorë të 1.541 numrave apo gjithsej 5.827 numra telefoni. Janë përgjuar mbi 20 mijë qytetarë. (O.Xh)

DEBAT PUBLIK MBI LIGJIN E RI PËR SHËRBIME MEDIATIKE, AUDIO DHE AUDIO-VIZUELE

MË SHUMË MJETE PËR RTVM-në

Ishte kryetari i Shoqatës së Gazetarëve, Naser Selmani, që ironizoi financimin e servisit publik me 15 milionë euro për këtë vit me pesë milionë euro më pak se sa viti i kaluar, edhe pse siç tha Selmani, kemi shtimin e programit 24 orë në gjuhë shqipe



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 27 mars - Të martën në Parlament gjatë debatit publik organizuar nga Komisioni për çështje evropiane lidhur me propozim-ligjin e ri për shërbime mediatike, audio dhe audio-vizuele kryesisht kishte vlerësime se Ligji në fjalë ka për qëllim reformat në media. Ndërkaq vërejtjet ishin në buxhetin e propozuar për servisin publik dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për media dhe Këshillit programor të RTVM-së. Ishte kryetari i Shoqatës së Gazetarëve, Naser Selmani, që ironizoi financimin e servisit publik me 15 milionë euro për këtë vit me pesë

milionë euro më pak se sa viti i kaluar, edhe pse siç tha Selmani, kemi shtimin e programit 24 orë në gjuhë shqipe. "Si Shoqatë e Gazetarëve kemi dy vërejtje - njëri të sqarohet për nominim për anëtarë në Këshillin për media, tjetra që të rritet financimi për RTVM-në. Fondet e planifikuara për financimin e Radiotelevizionit të Maqedonisë nuk janë të mjaftueshme për të qenë në gjendje të realizojë programet e reja që mundësohen sipas Ligjit, program 24 orë në gjuhën shqipe dhe program 24 orësh dhe kanal për pakicat. Në vitin 2017, Radio Televizioni i Maqedonisë kishte rreth 20 milionë euro, dhe nëse do të miratohet ky

Ligj, do të ketë 15 milionë euro. Si mundet me më pak para të bëjmë shërbim më të mirë publik", theksoi Selmani. Ai më tej përmendi moshën mesatare prej 57 vjetësh të stafit të RTVM-së, si dhe nevojën për punësim të reja, duke u fokusuar në këtë rast edhe tek shtimi i korrespondentëve që, sipas Selmanit, janë të paktë për momentin dhe nuk mund të mbulojnë ngjarjet në të gjithë territorin. Publikisti dhe redaktori përgjegjës i gazetës KOHA, Emin Azemi kishte vërejtje se Ligji për shërbime audio dhe audio-vizuele më shumë merret, siç tha ai, me teknikalitete se sa në formimin profesional të stafit punues qoftë në media - qoftë në

organet që merren me rregullimin mediatik. Dejan Georgievski nga Qendra për Zhvillimin e Mediave kishte vërejtje se Ligji i propozuar në disa raste nuk është kompaktibil me direktivat për media të Bashkimit Evropian. Ndërkaq, ministri i Administratës Publike dhe Shoqërisë Informatike, Damjan Mançevski, në lidhje me financimin e RTVM-së, tha se më shumë duhet punuar në aspektin e brendshëm të menaxhimit të financave me servisin publik. "Ka mendime të ndryshme edhe për financimin e shërbimit të transmetimit publik. Qeveria ka një bazë për të ndihmuar me prokurimin e pajisjeve, sepse duhet qytetarët ta dinë se

ku shpenzohen paratë e tyre. Ne jemi të gatshëm dhe kemi një bazë mbi të cilën mundemi që Radio Televizionin e Maqedonisë ta ndihmojmë në shtimin e pajisjeve të reja, por analiza e menaxhimit të parave duhet të jetë e brendshme dhe të dimë se për çfarë shpenzohen paratë", theksoi Mançevski. Sa i përket vërejtjeve se votimi me 2/3 lë hapësirë për kalkulime politike mes partive në pushtet dhe atyre opozitare, ministri pa resor që mbulon mediat, Robert Popovski, tha se nuk duhet të shqetësohemi për këtë, meqë sipas tij, shumica prej 2/3 nuk nënkupton negociata politike, por konsensus politik.

Tani që zyrtarët e MASH dështuan të korigjojnë nenin, me të cilin universitetet në gjuhën shqipe duhet të realizojnë minimum tre lëndë në gjuhën maqedonase, është radha e deputetëve të dëshmojnë nëse do të lejojnë të kalojë ose jo nenin 144 të propozim-ligjit për arsim të lartë

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 27 mars - Paradoksi i përdorimit të gjuhës maqedonase në të paktën tri lëndë për çdo program studimor të universitetet që nuk zhvillojnë veprimtarinë e tyre në gjuhën maqedonase rrezikon të kalojë si i tillë edhe në Ligjin e ri të

ASNJË NDRYSHIM NË PROPOZIM-LIGJIN SA U PËRKET UNIVERSITETEVE SHQIPE

MBETEN TRI LËNDË NË MAQEDONISHT!

arsimit të lartë, i cili pritet të miratohet së shpejti. Pavarësisht sensibilizimit dhe reagimeve në gazetën KOHA, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) nuk e korigjoi këtë detyrim ligjor as në variantin përfundimtar të tekstit për Propozim-ligjin që iu dërgua Parlamentit ditë më parë. Ndryshimi i vetëm që është bërë lidhet me spostimi i tij nga nenin 132 në nenin 144. Pra, nga varianti paraprak i Propozim-ligjit që deri në fund të shkurtit ishte nxjerrë për debat publik, në variantin final të atij Propozim-ligji (aktualisht në debat parlamentar) MASH nuk i ka hequr as një presje mendësisë që gjuha maqedonase të përdoret në minimum tre lëndë edhe në institucionet e arsimit të lartë në gjuhën shqipe, turke apo angleze. Është ndërruar vetëm vendi (neni) nga 132 në 144. Rrjedhimisht, Universiteti i Tetovës (UT), Universiteti i

Evropës Juglindore (UEJL) dhe Universiteti "Nënë Tereza" Shkup (UNT) për çdo program studimor duhet të organizojnë mësim në gjuhën maqedonase, përveçse për lëndën në këtë gjuhë - edhe për të paktën dy lëndë të tjera për të gjitha programet studimore pa dallim sferës së shkencave në të cilën bën pjesë ai program. "Kur mësimi realizohet në gjuhën e prestatëve të etniteteve jo shumicë në republikën e Maqedonisë ose në gjuhë të huaj, konform alineve 2, 3 dhe 4 të këtij neni, gjuha maqedonase realizohet si lëndë e veçantë mësimore dhe mësimi realizohet në gjuhën maqedonase në të paktën edhe dy lëndë të tjera mësimore të programit studimor", qëndron në nenin 144 të Propozim-ligjit për arsim të lartë. Nëse ky nen nuk korigjohet para seancës për miratimin e tij në Parlamentin e Maqedonisë, detyri-

mi i UT-së, UEJL-së dhe UNT-së për të realizuar mësim në gjuhën maqedonase (gjuhën si lëndë e veçantë) dhe në dy lëndë të tjera mësimore është shumë i qartë. Në formulimin e atij neni gjithçka qëndron e shkruar qartë, si "e zeza në të bardhë", ndërsa e mundësia për mos respektimin të këtij ligji nga ana e institucioneve arsimore është çështje tjetër diskutimi. UT, UEJL dhe UNT mund të marrin përsipër rrezikun e mos respektimit të këtij neni, ashtu sikurse mund të mos respektojnë edhe shumë nene të tjera që nuk shkojnë për shtati me interesat e tyre. Por, në cdo rast kemi të bëjmë me shkelje ligjore. Zyrtarët shqiptarë të MASH-it kishin mundësi të kërkojnë korigjimin e neneve që lidhen me përdorimin e gjuhës në institucionet e arsimit të lartë para se të firmosin variantin final të Propozim-

ligjin për arsim të lartë ose mos ta nënshkruan fare atë Propozim. Tani është radha e deputetëve, të lejojnë kalimin e nenit 144 në Parlament ose të kërkojnë korigjimin e tij, respektivisht ndalimin e tij. Në kohën kur Ligji për përdorimin e gjuhëve, pritet të avancohet përdorimin e gjuhës shqipe në instanca shumë më të larta politike sesa përdorimi i saj në institucione arsimore, është naive të lejohej nxjerrja e ligjeve të i obligojnë edhe më tej universitetet shqiptare që ti realizojnë në gjuhën maqedonase minimumi tri lëndë mësimore. Ligji i gjuhëve nuk ka si të rregullojë çështjen e përdorimit të gjuhës në institucionet e arsimit të lartë, kur për këta të fundit nxirren ligje të veçanta të cilat e rregullojnë edhe çështjen e përdorimit të gjuhëve e, që në rastin konkret është Ligji për arsim të lartë.

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 27 mars - Maqedonia renditet ndër shtetet në rajon që më pak eksporton ujë të ambalazhuar jashtë kufijve të saj, që kap vlerën prej vetëm 330 mijë euro. Këto shifra na vendosin, ndër shtetet e fundit në rajon për eksportin e ujit të ambalazhuar. Eksportuesi më i madh në rajon i ujit me 16.2 milionë dollar është Serbia, i pasuar nga eksporti kroat me vlerë 14 milion dollarë. Mali i Zi gjithashtu eksporton shifra modeste të ujit prej 200 mijë dollarë.

Një pjesë e menaxherëve të këtij biznesi vlerësojnë se kapacitetet e vogla për ambalazhimin e ujit, si dhe mungesa e interesimit më të madh për shitjen e ujit jashtë shtetit, janë shkaqet kryesore që Maqedonia përkundër potencialit të madh për të eksportuar ujë mbetet me shifra modeste në eksport.

Nga kompania kroate "Mali Loshinj" që ka investuar 14 milionë euro në fabrikën e ujit në Dibër dhe vazhdon akoma të investojë në prodhime të reja, thonë se nuk është e pamundur të eksportohet ujë nga Maqedonia jashtë shtetit, por kjo kërkon investime të mëdha si në prodhim ashtu edhe në promovimin e ujit nga Maqedonia jashtë shtetit.

"Ne si kompani për shishet prej 0.5 litra kemi kapacitetin e prodhimit prej 22.500 shishe në orë, që është për tre herë më shumë se kompania më e madhe në Maqedoni me 8000 shishe në orë. Nga ana tjetër, investojmë vazhdimisht në promovimin e ujit jashtë Maqedonisë në tregjet e jashtme dhe në fokus kryesor kemi eksportin e ujit nga kapacitetet tona. Aktualisht eksportojmë në Kosovë, Mal të Zi, Kroaci, dhe pas një jave edhe në

TREGJET BOTËRORE TË UJIT

MAQEDONIA NË MARGJINA

Një pjesë e menaxherëve të këtij biznesi vlerësojnë se kapacitetet e vogla për ambalazhimin e ujit, si dhe mungesa e interesimit më të madh për shitjen e ujit jashtë shtetit të ujit, janë shkaqet kryesore që Maqedonia përkundër potencialit të madh për të eksportuar ujë mbetet me shifra modeste në eksport prej 330 mijë euro

Bahrein, Katar dhe Arabinë Saudite. Jemi duke përgatitur për eksport edhe për tregun në Rusi dhe Bjellorusi. Pra, nuk është e pamundur të eksportohet ujë i ambalazhuar jashtë shtetit, por kjo kërkon kapacitete më të mëdha prodhuese dhe investim në marketing që mund të shkojë edhe në dhjetë për qind të vlerës së shitjes si dhe plotësimin e standardeve të larta të cilësisë së ujit që kontrollohen në laboratorët e jashtme për tregjet përkatëse", thotë Kujtim Deari, drejtor i fabrikës së ujit mineral "Maja" nga Dibra. Sipas tij për potencialin e madh të eksportit të ujit nga Maqedonia dhe rajoni, flet edhe fakti se vetëm Arabia Saudite harxhon pesë miliardë litra ujë të

ambalazhuar.

Në ndërkohë për konkurrencën e madhe në tregun e ujit të ambalazhuar në botë flet edhe fakti se pas brendeve më të njohura të prodhimit të ujit qëndrojnë kompanitë e fuqishme multinacionale. Italia me eksport të vlefshëm 480 milionë dollarë është eksportues i dytë në botë, pas Francës që renditet e para në botë me eksport të vlefshëm 600 milionë dollarë. Franca në tregun evropian shquhet me brendet "Evian", të Danon dhe Perrier të "Nestle". Edhe brendet italiane si San Pelegrino Nestle Voters apo San Benedetto dallohen në tregjet botërore.

Në dekadat e ardhshme vlerësohet se do të rritet me të madhe

kërkesa për ujë në shtetet me burime të pakta anembanë botës. Kjo paraqet një mundësi të madhe për fabrikat e ujit në Maqedoni të orientojnë një pjesë të prodhimit të tyre në eksport. Afaristët nga kjo veprimtari thonë se për të depërtuar në tregjet e shteteve të pasura të Lindjes së Mesme nevojitet ofrimi i një sasive të konsiderueshme që do të merr një pjesë të kulaçit mjaft atraktiv të tregut global të ujit të ambalazhuar. Vlerësohet se burimet e pastra natyrore, por edhe investimet dhe zgjerimi i kapaciteteve për paketimin e ujit në Maqedoni kanë potenciale, jo vetëm për të zëvendësuar importin e ujit të paketuar, por edhe për të rritur eksportet.

PROJEKTI RIKONSTRUKTUES NË FAZËN FILLESTARE

Punimet gjatë këtyre katër viteve janë zhvilluar duke kaluar përmes një sërë peripecish, financiare, teknike, mungesë të projektit bazë, e një sërë pengesash të tjera që kanë dalë gjatë punimeve në terren, ka theksuar drejtori. Sipas tij projekti gjendet në fazën e fundit ku pritet kompletimi me aparatura dhe teknologjinë skenike të nevojshme, si edhe montimi i tyre

TEATRI SHQIPTAR PRET KTHIMIN NË SHTËPI

Koha Evis HALILI

Shkup, 27 mars - Projekti për rikonstruktimin e Teatrit Shqiptar është në fazën e fundit të realizimit. Edhe pse punimet brenda godinës janë në kulmin e tyre, skelat e ngritura në pjesën më të madhe të objektit, drejtori i këtij institucioni Adem Karaga, ka deklaruar se gjenden pranë përfundimit të këtij projekti. Deklarata e tij është bërë gjatë vizitës së zëvendëskryeministrit Hazbi Lika dhe sekretarit shtetëror të Ministrisë së Kulturës, Valmir Aziri për të mbikëqyrur ecurinë e punimeve. Karaga ka përmendur se punimet gjatë këtyre katër viteve janë zhvilluar duke kaluar përmes një sërë peripecish, financiare, teknike, mungesë të projektit bazë, e një sërë pengesash të tjera që kanë dalë gjatë punimeve në terren, ka

theksuar drejtori. Sipas tij projekti gjendet në fazën e fundit ku pritet kompletimi me aparatura dhe teknologjinë skenike të nevojshme, si edhe montimi i tyre.

"Është një lajm i mirë për njerëzit që merren me teatrin dhe për publikun që të kenë një hapësirë të re konform standardeve evropiane, e kompletuar me pajisjet më të reja teknologjike teatrore që do të ofrojnë punë më cilësore dhe publikut kënaqësi maksimale të vizituarit të teatrit. Brenda këtyre katër viteve që po sillemi si nomadë dhe duke u përpjekur maksimalisht që të realizojmë programin vjetor për të cilin kemi hasur vazhdimisht në vështirësi, mezi presim të kthehemi në shtëpi, për të qenë më komodë në punën që ne bëjmë dhe të flakim tutje të gjitha ato vështirësi që kanë qenë pengesë. Penge-

sat financiare dhe ato teknike kuptohet që kanë lënë shenjat e veta duke zvarritur përfundimin e projektit, por Zëvendëskryeministri Hazbi Lika gjatë vizitës në teatër, me rastin e Ditës Botërore të Teatrit ka premtuar përfundimin e shpejtë të punimeve dhe mbështetje maksimale për teatrin dhe projektet e tjera në kulturë.

"Qëllimi i vizitës në këtë projekt gjigand është që të solidarizohemi me Ditën botërore të teatrit dhe të japim impulse të mëtejshme të këtij projekti që t'iu kthehet pronarëve dhe sa më shpejt në të të zhvillohen evente kulturore. Rikonstruktimi po bëhet duke iu përshtatur të gjitha standardeve ndërkombëtare dhe ne si Qeveri kemi dhënë mbështetjen tonë maksimale dhe kemi bërë çmos që punimet rikonstruk-

tuese të vazhdojnë, pasi sa më shpejt të përfundojë aq më mirë është për të gjithë ne. Mbështetja jonë për kulturën shqiptare do të vazhdojë edhe me projekte të tjera, për të avancuar edhe më shumë kulturën shqiptare", ka thënë Lika.

Punimet po ecin me hapa të përshpejtuara dhe sipas parashikimeve pritet të përfundojnë në muajt e parë të vjeshtës, atëherë kur do të vihet në skenë edhe shfaqja e parë. Projekti hasi në një sërë pengesash që në vitin e parë, pas falimentimit të kompanisë italiane që duhej të merrej me rikonstruktimin. Në mungesë të planit fillestar, projektantët hasën në probleme teknike në terren, ndërsa kufizimet financiare dhe buxheti që i akordohej çdo vit shkaktuan zvarritjen e punimeve.

DITËT E FUNDIT PËR ZGJIDHJEN E NGËRÇIT NË KËSHILL

DERI TË HËNËN AFATI PËR KRIJIMIN E SHUMICËS

Nëse deri më 31 mars nuk zgjidhet asnjë Komision komunal dhe as kryetari i Këshillit, si dhe nuk votohet miratimi i llogarisë përfundimtare i Komunës për vitin e kaluar, ka mundësi që të shkohet në zgjedhje të reja për këshilltarë të Komunës së Tetovës



kryetarin, njëkohësisht edhe të formojë komisionet përkatëse. Grupi i këshilltarëve të BDI-së thonë se sa më shpejt që të jetë e mundur do të mbahet një mbledhje e Këshillit, ku do të zgjidhet kryetari dhe organet e tjera të nevojshme. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, gjithashtu ka premtuar sërish zhbllokimin e Këshillit Tetovës. Por, tani nga Komuna e Tetovës thonë se zgjidhja e kryetarit të Këshillit është lënë në duart të vet këshilltarëve. "Kohezion brenda Këshillit komunal ekziston. Meqë ky unitet është, atëherë e kemi parë të rrugës që këtë çështje ta zgjidhin vetë grupet e këshilltarëve. Megjithatë, ky proces ka një kornizë ligjore dhe disa data të cilat nuk mundën të shkelen për shkak se pason fuqia vepruese e Ligjit, atëherë është mirë që partitë politike të dakordohen për një emër që të mund të kryesojë me Këshillin Komunal", tha Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës. Nga admini-

strata e Komunës së Tetovës kanë bërë thirrje që ky ngërç të zgjidhet sa më shpejt për shkak të interesave të qytetarëve dhe të kthehet normaliteti në punën e Këshillit të komunës. "Interesat e qytetarëve dhe nevojat e përditshme të qytetarit lidhen direkt me pushtetin vendor, prandaj është e rrugës që kjo situatë të zhbllokohet dhe të rikthehet në normalitet, në funksion të qytetarit të Tetovës, të cilit duhet ti ofrohen shërbime çdo ditë, dhe të njëjtat këto shërbime janë të lidhura drejtpërdrejt me Këshillin Komunal si kuvend lokal i cili merr vendime tejet të rëndësishme", deklaroi Fazliu. Edhe përbërja e Këshillit të kaluar i Komunës së Tetovës ishte bllokuar për një kohë të gjatë, sepse Këshilli nuk mund të formonte një shumicë. Pas negociatave të gjata, shumica përbëhej nga BDI dhe VMRO-DPMNE, pasi të dyja palët ranë dakord të ndanin funksionet udhëheqëse në komunë. Dragan Davidovski, i cili

ka një përvojë më të gjatë në Këshillin e Komunës së Tetovës, thotë se vonesa në Këshillin e ri është për shkak të negociatave politike të partive. Ai shpreson se arsyeja do të mbizotërojë, dhe se shumë shpejt do të zgjidhet shumica dhe kryetari i Këshillit. Përndryshe, nëse deri më 31 mars nuk zgjidhet asnjë Komision komunal dhe kryetari i Këshillit dhe nuk votohet miratimi i llogarisë përfundimtare e komunës për vitin e kaluar, ka mundësi që të shkohet në zgjedhje të reja për këshilltarë të Komunës së Tetovës. Fillimisht kishte një përpjekje që të krijohet shumicë, kur kryetar Këshilli u zgjodh Adnan Bilalli nga PDSH, por më pas u konstatua se zgjedhja e tij nuk ishte legjitime. Përndryshe, me vendim të Qeverisë, për të mos u bllokuar puna në komunë, Ministria e Financave e ka pranuar Buxhetin e Komunës së Tetovës i cili kohë më parë kaloi me shumicë votash, por pa nënshkrim të kryetarit të Këshillit.

Sulmuar një punëtor social në Qendrën e Gostivarit

Gostivar, 27 mars - Një punëtor social nga Qendra e Punëve Sociale në Gostivar, mbrëmë është sulmuar fizikisht në vendin e punës nga një banor i fshatit Leunovo. Sipas SPB Tetovë, sulmi ka ndodhur mbrëmë rreth orës 11 kur R.T.(61) derisa ka qenë në lëvizje në korridorin e qendrës i është afruar D.G.(19) nga Leunovo, ka filluar t'i bërtasë, t'i kërcënohet dhe pastaj fizikisht e ka sulmuar, duke e goditur me grushte në shpinë dhe në trup. Në shpejtësi janë përfshirë të punësuar në Qendër dhe e kanë ndaluar D.G. të vazhdojë me sulmin, pas çka është privuar nga liria për zbardhjen e rastit dhe kundër tij do të pasojë parashtrësë përkatëse. Sulmuesi edhe më herët ka qenë i lajmëruar për sjellje të dhunshme, ndërsa kundër tij si adoleshent janë parashtruar disa kallëzime në periudhën e kaluar.

Do të hiqen tezgat e paligjshme në Bit Pazar dhe në Çarshi të Vjetër

Shkup, 27 mars - Qyteti i Shkupit dhe Komuna e Çairit me mbështetjen e esnafit të Çarshisë së Vjetër dhe Odës së Tregtarëve në Republikën e Maqedonisë kanë marrë për obligim para qytetarëve t'i që lirojnë rrugët dhe trotualet me qëllim të zhvillimit të qarkullimit. Në afërsi të drejtpërdrejtë të Bit Pazarit është paraparë vendosja e stacioneve të reja të taksive, rregullimin e hapësirave të gjelbërta dhe shtylla mbrojtëse për trotualet nga të dyja anët e bulevardit. Këtë në konferencë për shtyp e kumtoi zëdhënësi i Qytetit të Shkupit, Valon Salihu. Ai shtoi se në mënyrë shtesë planifikohet edhe rregullimi dhe ndriçimi i pasazheve në Çarshinë e Vjetër të Shkupit. Qyteti i Shkupit, siç tha, ka mirëkuptim se tregtarët të cilët punojnë në këto tezgat të vendosura në mënyrë të paligjshme bëjnë shumë përpjekje që të fitojnë për mjetet themelore për jetë. Për këtë shkak, në bashkëpunim me "Tregun e Shkupit" u siguroam që këtyre personave t'u ofrohen në shfrytëzim tezgat në suaza të Bit pazarit nën kushte të volitshme të caktuara. Salihu informoi se për këtë qëllim duhet të lidhin marrëveshje me "Tregun e Shkupit" SHA Shkup, por paraprakisht duhet të lajmërohen në numrin e telefonit 02 311 880 më së voni deri më 5 prill të këtij viti. me ata që nuk do ta bëjnë këtë dhe do të vazhdojnë të shesin në rrugë apo në trotuar do të gjobiten konform ligjit nga ana e inspektimeve kompetente.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 27 mars - Këshilli i Komunës së Tetovës ende është i bllokuar dhe jofunksional për shkak të mos krijimit të shumicës. Kësisoj, kanë ngelur edhe disa ditë, respektivisht deri më 31 mars grupet e këshilltarëve duhet të formojnë shumicën, në të kundërtën - do të duhet të shkohet në zgjedhje vetëm për listat e këshilltarëve. Pas mbajtjes së seancës konstituive dhe miratimit të Buxhetit, Këshilli vetëm një herë mbajti mbledhje të jashtëzakonshme lidhur me zjarrin që kaploi një shtëpi në Tetovë, ku kishte pesë viktima. Që prej atëherë, Këshilli nuk ka patur asnjë tentim për të mbajtur mbledhje dhe të krijojë shumicën dhe të zgjedh

Paga minimale i dha rezultatet e pritura

Shkup, 27 mars - Paga minimale i dha rezultatet e pritura. Ajo përveç që i barazoi të punësuarit në industrinë e tekstilit, lëkurës dhe këpucëve me degët e tjera, kontribuoi për rritje të pagës mesatare me këta sektorë, por edhe të pagës mesatare në Maqedoni në vlerë prej 5,6 për qind, deklaroi sot ministrja e Punës dhe Politikës Sociale Milla Carovska. Me këtë, tha, është arritur rritje e pagës mesatare në prodhimtarinë e rrobave për 16 për qind, ndërsa në industrinë e tekstilit mbi 24 për qind, ose rritje prej 3.870 denarë.

Informoi se 90.000 punonjës kanë marrë mbi 12.000 denarë pagë. Prej tyre, vetëm 10 mijë janë subvencionuar nga shteti që tregon se ligji implementohet pa absorbim të madh të mjeteve buxhetore. Kjo, sipas saj,

thekson se firmat janë në kondicion të mirë, dhe se masa nuk është e parakohshme. Drejtori i OKITEKS Mile Milenkovski, i cili së bashku me përfaqësuesin e Sindikatës pranë LSM-së Dushko Radovski kishte takim me ministrën në fabrikë, tha se në bisedimet janë dakorduar se Ligji për pagë minimale e ka dhënë rezultatit e pritur. Shtoi se pas kësaj nevojitet të ecet përpara me modernizim që do të sjellë për eksport më të madh të prodhimeve në Evropë.

Me rritjen e pagës minimale, por para së gjithash edhe barazimit të saj me të gjithë degët, sipas Radovskit, Sindikata ka arritur të bëjë kushte që punonjësit nga këto tre degë të mos jenë nga rendi i dytë dhe ta marrin vendin e merituar në Maqedoni. Ajo tha



se bisedimet duhet të vazhdojnë, për shkak se, siç tha, kur ka dëshirë dhe vullnet të takoheni dhe të bisedoni për problemet e tjera të cilat i prekin edhe njëherë por edhe palën tjetër atëherë mund të arrihet zgjidhje e suksesshme.

ÇKA PASTAJ, Maqedonia pas zgjidhjes së kontestit të emrit



Nga
Bilal KASAMI

Të gjithë jemi të koncentruar në një problem që tanimë duket i pazgjidhshëm edhe pse jemi më afër zgjidhjes së kur më parë e që është kontesti i emrit të shtetit me Greqinë. Për më shumë, gati të gjitha resurset kombëtare dhe ndërkombëtare i kemi orientuar që të merren me zgjidhjen e këtij problemi. Aq shumë jemi të preokupuar më këtë problematikë sa që shumë pak, për të mos thënë se fare nuk merremi më atë se çka pastaj! Pa u futur në atë se kush ka të drejtë e kush e ka gabim, në këtë tekst dua të ofroj një kuadër më të gjerë të problemit me të cilin po ballafaqohemi të gjithë pa dallim edhe pse maqedonasit duan ekskluzivitet të plotë në zgjidhjen e problemit me emrin e shtetit. Për më shumë se njëzet vite Maqedonia nuk arrin të gjejë rrugën e duhur për një sistem shoqëror, i cili do të ofroj stabilitet të plotë të shtetit dhe do të krijojë mirëqenie për qytetarët.

Problemi me emrin e shteti është vetëm një tullë në murin e ngritur në mes të një Maqedonie të cilën e dëshirojmë të gjithë, por nuk e kemi dhe asaj në të cilën jetojmë, por gati se askush nuk e do për një arsye apo tjetër. Dhe e gjitha kjo si rezultat i paaftësisë së elitave politike që të marrin vendime të dhimbshme në momentin e duhur, por të patjetërsueshme për një të ardhme të ndritur të të gjithë qytetarëve, por edhe të shtetit në tërësi. Në momente të caktuara, moszgjidhja e çështjes së emrit të shtetit, po del se nuk është shkak i problemeve të shumta të shtetit, ashtu si duan ta prezantojnë politikanët. Por, gjithnjë e më shumë po shpërfaqet me fytyrën e vërtet si një pasojë e paaftësisë së elitave politike për të marrë vendime të rëndësishme në momente historike.

Ashtu si edhe në jo pak raste të tjera me të cilat jemi ballafaquar, shumë shpejt mund të ballafaqohemi me dëshpërimin e radhës e ai të jetë se edhe pasi të zgjidhim problemin e emrit, ne përsëri do të vazhdojmë të rropatemi me një gjyqësor, i cili më shumë merret me montim të rasteve kundër shqiptarëve se sa që merret me atë që e ka për obligim me kushtetutë dhe ligj, ndarje të drejtësisë për të gjithë. Edhe më tutje do të vazhdojmë të merremi me zgjidhje parciais të problemeve të grumbulluara ndër vite e që ndërliken me marrëdhëniet ndëretnike. Mos të flasim që ende nuk e kemi idenë e ndërtimit të një sistemi të

mirëfilltë të një ekonomie të tregut të lirë, e cila as që do të ia dijë për intervenime politike.

Që nga momenti i zgjidhjes definitive të çështjes së emrit, do të zgjohemi me realitetin e hidhur që e kemi ndërtuar ndër vite për këto gati 30 vjet tranzicion të munguar. Që kontradikta të jetë edhe më e madhe, ky nuk do të jetë një zgjim i vetëdijshëm nga gjumi letargjik që na ka kapluar për këto vite të humbura, por do të jetë edhe një tentim nga partnerët tanë ndërkombëtarë, veçanërisht shtetet mike të BE-së dhe SHBA-të, për të na kthjelluar e rikthyer në realitetin e hidhur në të cilin jetojmë. Dhe përsëri e përsëri, elitat politike duke mos pasur guxim e nevojshëm për të njoftuar opinion se kemi fituar një betejë të vogël për t'kthyer në luftën e madhe që na pret dhe në mungesë të plotë të një vizioni të qartë për të ardhmen e shtetit, fajin do t'ua hedhin miqve tanë se ata nuk janë të gatshëm të na ndihmojnë sikur të na e kenë këtë borxh, që të kujdesen për ne më shumë se që ne duhet kujdesemi për vetveten.

Me fjalë tjera, se nuk kemi bërë ndonjë punë të madhe me atë që e kemi zgjidhur çështjen e emrit, por veçse kemi larguar një gur nga rruga

jonë drejtë të ardhmes më të mirë në familjen e madhe evropiane, përsëri përkujtimi do të na vijë nga institucionet e BE-së. Dështimin që të kemi një jetë më të mirë, një jetë të dinjitetshme, dështim, pasojat e të cilit do të vazhdojmë t'i ndiejmë fuqishëm edhe pas zgjidhjes së këtij problemi, edhe më tutje do të vazhdojmë ta lexojmë në raportet e progresit, për mos të thënë të regresit, të përgatitura nga institucionet e BE-së. Dhe, pasi t'i lexojmë, do të pasojnë komente e analiza të shkurtra e të gjata, nga analistë e intelektualë të ndryshëm të pozitës e opozitës, nëpër media e çajtoje, se sa keq po jetojmë, se këtu përfundimisht nuk ja vlen të kërkuar zgjidhje. Më pak për shkak të opozitës e më shumë për shkak të pozitës, maqedonasit duke i fajësuar shqiptarët e këta duke fajësuar maqedonasit. Por, përsëri rezultati do të vazhdojë të jetë po ai i njëjti, një jetë që nuk ja vlen edhe aq për ta jetuar në një shtet pa shtet, ekonomi pa zhvillim, gjykata pa drejtësi, shëndetësi pa shëndet, kulturë pa kulturë...

Pra, për gjithë qytetarët e këtij shteti, pa marrë parasysh se si do ta quajmë atë nesër, elitat politike, që sot duhet të ofrojnë një vizion më të


Nuk arrijmë që bashkërisht të ulemi e të merremi vesh që çdonjëri të bëjmë atë që dimë të bëjmë më së miri edhe si individ, por edhe si pjesëtarë të një grupi të caktuar, lirisht mund të konstatojmë se nëse jo të gjithë qytetarët e këtij shteti, me siguri që pjesa dërrmuese e tyre do ta gjejnë Evropën, por të gjithë ne pa dallim do ta humbim Maqedoninë

qartë për atë që na pret pas zgjidhjes së çështjes së emrit, duhet t'u tregojnë qartë qytetarëve së kompromisi më i dhimbshëm nuk është kompromisi për emrin, por ajo që na pret pastaj. Sepse, megjithatë në një botë të egër përsëri duhet që vetë të përveshim krahët e të ndërtojmë një sistem të mirëfilltë të drejtësisë, i cili do të ndajë drejtësi për të gjithë, do të ndërtojë një sistem ekonomik që do të përkrah të suksesshit që të kenë suksese më të mëdha, sepse kështu do të jemi të gjithë të suksesshëm, do t'i zgjidhim problemet që dalin nga diversiteti shoqëror duke respektuar tjetrin dhe përfundimisht duke kuptuar se nuk mund të ketë zgjidhje të kënaqshme për mua duke dëmtuar komshin, i cilës do përkatësi qoftë ai. Dhe për fund, nëse nuk arrijmë që bashkërisht të ulemi e të merremi vesh që çdonjëri të bëjmë atë që dimë të bëjmë më së miri edhe si individ, por edhe si pjesëtarë të një grupi të caktuar, lirisht mund të konstatojmë se nëse jo të gjithë qytetarët e këtij shteti, me siguri që pjesa dërrmuese e tyre do ta gjejnë Evropën, por të gjithë ne pa dallim do ta humbim Maqedoninë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 27 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



Nga Endrju HIGINS

NJË TJETËR LUFTË E FTOHTË ME RUSINË? JO, ËSHTË MË KEQ SE KAQ

Dëbimi i shumë diplomatëve rusë nga Shtetet e Bashkuara, vendet anëmbanë Evropës dhe më gjerë, ka ngritur përsëri pyetjen, nëse bota po kthehet atje ku ishte gjatë Luftës së Ftohtë. Përgjigja alarmante nga disa në Rusi është: Jo, por situata është në disa drejtime, edhe më e paparashikueshme. Pavarësisht të gjitha tensioneve, konflikteve me të tretët, dhe rrezikun e luftës bërthamore që shënjoj marrëdhëniet reciproke Moskës dhe Perëndimit për dekada, secila palë e dinte, veçanërisht aty afër përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe rënies së Bashkimit Sovjetik më 1991, se çfarë duhet të priste. Secila prej tyre kishte një nivel besimi, se pala tjetër do të veponte në mënyrë të arsyeshme dhe të parashikueshme.

Gjendja e paqëndrueshme e marrëdhënive të Rusisë me botën e jashtme sot, e përkeqësuar nga një sulm me agjentë nervorë ndaj një ish spiuni që jeton në Britani, megjithatë e bën klimën diplomatike të Luftës së Ftohtë të duket shumë e qetë, thotë Ivan I. Kurilla, një ekspert për marrëdhëniet ruso-amerikane, i cili kujton një periudhë paralizuese mosbesimi, që pasoi revolucionin bolshevik të vitit 1917.

"Nëse kërkon ngjashmëri me atë që po ndodh, nuk është Lufta e Ftohtë që mund të shpjegojë ngjarjet, por regjimi i parë revolucionar i Rusisë", i cili vriste rregullisht kundërshtarët jashtë vendit, thotë Kurilla, historian në Universitetin Evropian në Shën Petersburg. Ai thotë se presidenti i Rusisë, Vladimir V. Putin, nuk kishte interes të përhapte një ideologji të re dhe të nxiste revolucionin botëror, ndryshe nga bolshevikët e hershëm, por Rusia nën Putinin "u bë një regjim revolucionar, në aspektin e marrëdhënive ndërkombëtare".

Nga këndvështrimi i Kremlinit, Shtetet e Bashkuara janë ato që përmbysën normat e mëhershme, kur Presidenti Bush tërhoqi Shtetet e Bashkuara nga Marrëveshja kundër raketave anti-balistike, një traktat i rëndësishëm i epokës së Luftës së Ftohtë, në vitin 2002. Rusia, thotë Kurilla, nuk i pëlqen rregullat e rendit të dominuar nga Amerika, që kanë mbizotëruar qysh prej atëherë, "dhe dëshiron t'i ndryshojë ato". Megjithatë, një rregull që Rusia e ka pranuar vazhdimisht është parimi i reciprocitetit, dhe Kremlini e bëri të qartë të hënën, se pas vlerësimit të shkallës

Të gjendur përballë veprimeve trazuese të Moskës në vitet 1920, Britania dhe vendet e tjera evropiane "nuk dinin si të përgjigjeshin, dhe iu deshën 10 vite që të gjenin se si të merreshin me Moskën", thotë Kurilla, historiani i Shën Petërburgut. Në rastin e Britanisë, fuqia kryesore e kohës dhe i pari vend perëndimor që njohu Bashkimin Sovjetik, procesi ka jehona të të tashmes

së dëmit të trupës diplomatike të jashtme, do të përgjigjet me dëbimet e diplomatëve perëndimorë nga Rusia. Parlamenti rus gjithashtu ndërhyri, teksa nënkryetari i komisionit të punëve të jashtme, Aleksei Chepa, i tha agjencisë së lajmeve Interfax, se Rusia nuk do të përkulet në "luftën" diplomatike ndaj Perëndimit. Rusia, tha ai, "nuk do të lejojë që të 'rrihet', sa më shumë përpiqen të na frikësojnë, aq më e ashpër do të jetë përgjigja jonë".

Kur Britania dëboi 23 diplomatë rusë këtë muaj, në përgjigje të sulmit me agjent nervor në Salisbury të Anglisë, Moska jo vetëm që dëboi një numër të njëjtë diplomatësh britanikë, por urdhëroi mbylljen e British Council, një organizatë që promovon kulturën dhe gjuhën britanike.

Ndërkohë që mohon të ketë rol në helmimin në 4 mars të Sergei V. Skripal, një ish spiun dhe bijës së tij Yulia, ku të dy janë rëndë në spital, Rusia vitet e fundit ka shtuar aktivitetin e saj në shkeljen e normave ndërkombëtare, sidomos me aneksimin e Krimesë në vitin 2014, hera e parë qysh prej vitit 1945, që kufijtë evropianë ribëhen me forcë. Sulmi ndaj Skripalëve ishte një tjetër herë e parë, të paktën sipas kryeministres Theresa May e Britanisë, e cila

e denoncoi këtë veprim si "të parin sulm me një agjent kimik nervor në Evropë, që nga Lufta e Dytë Botërore". Kadri Liik, një studiuese në Këshillin Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë, tha se është e shastisur nga sulmi me agjentin kimik. Liik tha se kishte pritur që Putini, i cili fitoi një mandat të katërt me shumicë të madhe në 18 mars, do të sprapset nga këto veprime, gjatë atyre që sipas Kushtetutës, duhet të jenë gjashtë vitet e tij të fundit në pushtet.

Z. Putin, tha ajo, mund të mos jetë i parashikueshëm, por zakonisht ndjek atë që ai e konsideron logjikë mjaft të qartë. "Putin nuk bën trazira vetëm për t'u dëfryer, por sepse ai është Putin dhe ai mundet", tha ajo. Çdo herë që Rusia është akuzuar se ka dorë në akte të tilla si konfiskimi i ndërtesave qeveritare të Ukrainës në Krime ose goditja në vitin 2014, të një avioni malajzian pasagjerësh mbi Ukrainën lindore, ku u vranë afro 300 vetë, Moska ka reaguar me një përzjerje të vetë-keqardhjes, mohimit të fortë dhe teorive të konspiracionit, që e shpjen fajin tjetërkund. Në rastin e helmimit në Salisbury, mohimet e Rusisë u bënë kaq baroke, sa që edhe mediat shtetërore e patën të vështirë t'i përcjellin.

Pasi zyrtarët mohuan ndonjë rol rus dhe këmbëngulën që as Rusia, as Bashkimi Sovjetik, kurrë nuk kishin zhvilluar Novichokun, agjentin kimik nervor, i identifikuar nga Britania si substancë e përdorur kundër Skripalëve, një agjenci lajmesh e kontrolluar nga shteti, botoi një intervistë me një shkencëtar rus, i cili tha se ai kishte ndihmuar në zhvillimin e një sistemi armësh kimike të quajtur Novichok-5. Agjencia më vonë ndryshoi artikullin, duke zëvendësuar përmendjen e Novichok nga shkencëtari, me një pohim se "programi i zhvillimit të armëve kimike nga BRSS nuk ishte quajtur 'Novichok'".

Vrasja në tentativë e Z. Skripal në tokë britanike, megjithatë, "ishite bllok i kashtës që theu shpinën e devesë", thotë Vladimir Inozemtsev, një studiues rus në Institutin Polak të Studimeve të Avancuara në Varshavë. "Udhëheqësit perëndimorë më në fund vendosën se ka vajtur aty ku nuk mban më", sepse Moska e ka lajuar kaq shumë herë lojën e mohimit, dhe nuk ka bërë asgjë për zbardhjen e të vërtetës, tha ai.

Ndryshe nga udhëheqësit sovjetikë gjatë Luftës së Ftohtë, shtoi ai, Putini nuk ndjek një ideo-

logjiose rregulla fikse, por është i gatshëm të ndjekë cilatdo politika "grabitqare", sado tabu të jenë ato, me qëllim "që të dëmtojë rendin ekzistues në Evropë", ndërkohë që njëkohësisht të këmbëngulë se Rusia është viktimë dhe jo agresori. Kur Kombet e Bashkuara në vitin 2015 propozuan një gjykatë ndërkombëtare për të hetuar katastrofën ajrore të MH-17 një vit më herët, mbi territorin e kontrolluar nga rebelët e armatosur nga Rusia në Ukrainën lindore, Moska përdori veton në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të bllokuar këtë veprim, i vetmi anëtar i Këshillit që e kundërshtoi hetimin.

Ian Bond, një ish-diplomat britanik në Moskë, i cili tani është drejtor i politikës së jashtme në Qendrën për Reformën Evropiane në Londër, tha se mohimet e shpeshta e jo të besueshme të Rusisë e kishin bërë atë "si djali që thirri ujku, ujku!". "Nëse vazhdon të hedhësh teoritë të çmendura konspirative, njerëzit në fund do të pyesin nëse ajo që po thua është thjesht një tjetër mohim i çmendur rus", thotë ai. Bond thotë se diplomacia gjatë Luftës së Ftohtë, edhe kur përfshinte veprime armiqësore, tentonte të ndiqte një rutinë relativisht të qetë dhe të rregullt. Nuk ndodh më kështu, shton ai, duke vënë në dukje se Ambasada Ruse në Londër dhe Ministria e Jashtme në Moskë kanë nxjerrë deklarata dhe postime në Twitter, që tallen me Britaninë si një ish-fuqi e pafuqishme, duke u tallur me helmimin e Salisbury si "e ashtuquajtura çështje Sergei Skripal". Presidenti Putin, shton Bond, "nuk është duke u përpjekur të nxisë revolucionin ndërkombëtar, por ai është prishësi i madh i tij" dhe kënaqet me stërkëmbështat që i vë qeverive të huaja, duke shkelur normat e vendosura.

Ndërsa Rusia mund të jetë habitur nga përmasat e dëbimeve të koordinuara nga aleatët e Britanisë të hënën, ishte e qartë se ajo kishte parashikuar diçka. Disa orë para se të njoftoheshin, u hodh në ofensivë. Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova, ka postuar një mesazh në Facebook, duke vënë në lojë Bashkimin Evropian se ka treguar solidaritet me Britaninë në një kohë kur Londra po negocion daljen e saj nga bllok.

Britania, shkruante ajo, është "duke shfrytëzuar faktorin e solidaritetit për t'u imponuar atyre që kanë mbetur në Union, një përkeqësim të marrëdhënive me Ru-

sinë". Ndërsa Presidenti Trump ka shprehur një afrim të çuditshëm me Putinin dhe ka rritur pritshmëritë për marrëdhënie të përmirësuar, udhëheqësi rus gjithmonë ka qenë më i matur. Ndërkohë, mosbesimi i thellë duket se u përforcua të hënën nga ambasadori i Rusisë në Uashington, Anatoli Antonov, i cili i tha agjencisë së lajmeve Interfax se "ajo që Shtetet e Bashkuara të Amerikës po bëjnë sot, po shkatërron atë pak që ka mbetur në marrëdhëniet Rusi-SHBA". Pavarësisht nga paparashikueshmëria nën Putinin, mundësia e konfliktit bërthamor midis rusëve dhe perëndimit, aspekti më i frikshëm i Luftës së Ftohtë, duket se nuk është rritur. Marrëveshjet e kontrollit të armëve të arritura që nga vitet 1970 vazhdojnë të respektohen – me përjashtim të marrëveshjes kundër raketave anti-balistike të vitit 1972, e njohur si Traktati ABM, të cilën Bush e braktisi 30 vjet më vonë.

Vendimi i zotit Bush, i kërkuar nga disa aleatë amerikanë, hapi rrugën, sipas pikëpamjes së Moskës, për një situatë ku të gjithë janë të lirë të bëjnë ç'të duan në marrëdhëniet ndërkombëtare, gjë që ka rritur vështirësitë e SHBA dhe Rusisë, për të rigjetur besimin e zhvilluar nga Presidenti Ronald Reagan dhe udhëheqësi i fundit sovjetik, Mikhail S. Gorbaçov, në vitet 1980. Në një fjalim para kombit në shkurt, Putini zbuloi atë që e quajti një gjeneratë të re raketash me rreze të gjatë (të parrëzueshme), por më pas në një intervistë për NBC, ai fajësoi Uashingtonin se e ka shtyrë Moskën në një tjetër garë armatimi, duke shpërfillur status quo-në e Luftës së Ftohtë. "Nëse flisni për garë armatimi, ajo nisi kur SHBA u tërhoq nga Traktati ABM", tha ai.

Të gjendur përballë veprimeve trazuese të Moskës në vitet 1920, Britania dhe vendet e tjera evropiane "nuk dinin si të përgjigjeshin, dhe iu deshën 10 vite që të gjenin se si të merreshin me Moskën", thotë Kurilla, historiani i Shën Petërburgut. Në rastin e Britanisë, fuqia kryesore e kohës dhe i pari vend perëndimor që njohu Bashkimin Sovjetik, procesi ka jehona të të tashmes.

Ajo njohu qeverinë bolshevike në vitin 1924, por më pas dëboi diplomatë sovjetikë dhe i vuri qepinat ambasadës së tyre tre vjet më vonë, pasi policia zbuloi atë që u tha se ishte një rrjet sovjetik spiunazhi, i cili synonte të mbillte kaos. (NYT)

Lum ajo letërsi që e ka një poete si Lindita Ahmeti

Salajdin SALIU

Linditë Ahmeti, poete, eseiste, studiuese dhe përkthyes, është zëri autentik në letërsinë bashkëkohore shqipe. Ajo u shfaq në botën letrare shqiptare në fillim të viteve 90 të shekullit 20. Ajo është poete e më së paku dy shekujve. Është pjesëtare e brezit të poetëve të post – komunizmit, që sollën diskurs dhe sensibilitet të ri krijues. Lindita Ahmeti është autore e disa librave me poezi, gjegjësisht: "Mjedra dhe bluz" (1993), "Ishulli adular" (1996), "Brezi i Zonjës" (2000), "Vetë përballë erosit" (2004), "Lulja alba" (2008), "Nga mëshhtëknaja e babait me mallëngjim" (2015) dhe "Dhoma pa derën dalëse" (2016). Katër libra të saj janë përkthyer në gjuhën maqedonase: "Камена месечина" (1998), "Син сон" (2002), "Призивање во април" (2007) dhe "Утрешните монети" (2011), kurse në gjuhën bullgare i është botuar libri "Пролетен копнеж" (2008). Linditë Ahmeti është rritur në një botë rrethuar me libra, në familje artdashësish, pranë një babai shkrihtar, Xhabir Ahmetit, një të dashuruar pas gjuhës dhe pas "fjalëve plaka e të harrueme", siç thotë Pjetër Bogdani. Ajo është poetja që i dalin zot tre qytete: Shkupi, Tetova e Prizreni. Ashtu siç ndodhi me Homerin, ashtu sikurse ndodh me çdo emër të veçantë të letërsisë. Lindita është e të gjithë qyteteve tona. Ajo është poete që e dëshiron secila hapësirë dhe kohë. Pa ekzagjerim. I përket atdheut të letërsisë. Kjo poete par excellence kryesisht e krijon vargun e lirë, të qetë, të rrjedhshëm, me balancë mahnitëse ndërmjet erudicionit dhe emocionit; të gërshetit të kohës historike me atë mitike, njëres lineare e tjetrës unazore, njëres njëdrejtimëshe e tjetrës ciklike. Është poezi ku gërshetohen imazhe të kohës sonë dhe të mitologjive të ndryshme: greke, romake, ilire etj. Poezia e saj shpesh ngjan si prozë poetike. Me bukurinë reflektuese na kujton thënien antologjike të Ferlingetit: "Poezia moderne është prozë, por ajo thotë shumë". Lindita është e heshtur. Ajo jeton në botën e heshtur. Ajo jeton me poezinë si rrallë poete tjetër. Ajo është poezia vetë. Në mes librash e dëgjon muzikën e heshtjes. Për ta përjetuar muzikën e kësaj bote nuk mjafton të dëgjosh tingujt, por heshtjen, ashtu si një Bethoven, që prej heshtjes çlironte muzikën e kohërave dhe ëndrrave e ia falte botës sonë të zhurmshme. Kur e lexon poezinë e Linditë Ahmetit e ndjen triumfin e gjuhës së harruar, gjuhës së ëndrrës, të figuracionit, kundrejt gjuhës së përditshmërisë, të klisheve e refreneve, zhveshur nga mendimi i thellë. Je pjesë e një ëndrre, e një parabote, e një përtejbote, e një tejbote. Poezia e saj është zëri i atyre që kanë ikur, i bashkuar me zërin tonë dhe të atyre që do të vijin. Është zëri i të vdekurve i shumëfishuar nga goja e një foshnje. Është klithje në humnerë dhe njëkohësisht ledhatim përjetësie mbi ballin e një vdekatare, siç thonë poetët. Është gjithçkaja dhe asgjëja për të cilën kemi nevojë. Është e bukura që na duhet dhe na duhet, pa merakun e të qenit e dobishme. Është paqja me mendimet, me ndjenjat, me ëndrrat dhe me vizionet tona për një botë më të mirë nga çfarë e kemi. Është bukuria shituese dhe shpëtimtare e kësaj bote të ngulfatur nga vargonjtë e ligësisë. Është e përhershme që ushqehet nga ambrozi dhe nektari i gjuhës. Është kënga e Hyjit në universin e qenësisë. Është ishulli i qetësisë ku strehohemi për të ikur nga rutina e refreni. Është atdheu pafundësisht i gjerë në kohë dhe hapësirë. Është fjala Njeri që mposht Sfinksin. Është zbulosa e të gjitha të mirave që i erdhën kësaj bote, që nga koha e fëmijërisë njerëzore e deri në kohën tonë. Poezia e Linditë Ahmetit i ngjan një aj-sbergu, sepse pjesa më e madhe e asaj që nuk e shohim mbetet diku në thellësi. Ky emër do të njihet edhe kur të jenë harruar shumë protagonistë të kohës sonë, që flasin shumë dhe ende nuk kanë thënë diçka të re. Lum ajo letërsi që e ka një poete si Lindita Ahmeti dhe mjerë ajo kulturë që nuk di ta çmojë një dhuratë të këtillë!



LINDITA AHMETI

UDHËTIMI I BABAIT NËPËR KËNGËN E VJESHTËS

hapat e babait nëpër natën vjeshtore me selenën e purpurt që hedh dritë në shteg e nxisin komunikimin me qetësinë e pyllit dhe kuptohen mirë mes vetes babai e qetësia babai ndonëse e ka një pyetje nostalgjike për vjeshtën s'e thotë me gojë s'e turbullon qetësinë po e shkruan pyetjen në fletët e heshtjes ulur në rrënjën e bungut janë foljet e shpërndara gjithandej që e çojnë babanë të ngrihet në këmbë ecën ai ndërsa gjethet e thata zgjohen dhe bëjnë muzikë xhazi nën këmbët e lodhura të plakut pastaj fryn pak eoli tingujt e butë të erës së freskët kur i ledhatojnë gjethet dhe dalja në skenë e mbiemrave të përmallshëm janë në të vërtetë përgjigje e vjeshtës për babanë e cila pëshpërit ju iku vera e blertë ju iku vera e blertë zogjtë të renditur si fjalët e demostenit para athinasve kur filipi futej në polis me ushtarët e tij kërkoi në shpresën e mirë duke lënë mbrapa ngjyrat e vjeshtës pastaj tingujt e freskët të gjethëve të thata kërcëllojnë bëhen vërejtje për krijesat e imta të pyllit për merimangat që prodhojnë mëndafshin më të mirë për mizat gjarpërinjtë minjtë buklat e shqarthat për ndonjë hardhucë të blertë që s'ndalet së vrapuari nëpër bar pas ndonjë kandre dhe për breshkat që e demonstrojnë hijerëndësinë kur ecin dhe ta merr mendja edhe për sutat e buta që e zbukurojnë pamjen e pyllit kur i bie hëna për të gjithë banorët e gjelbërimit që janë rehatuar në mbretërinë e gjumit jepet alarmi e shtohen thirrmat e larëve kujdes ndonëse babai shpërndan ëndrrën e bukur në këtë mbretëri magjepsë si gjithmonë bota e pyllit ka rendin e vet dhe e dëgjon vetëm përvojën e veshur me njëqind ngjyra që hedh hëna ajo shkon shtigjeve të saj pa e dalluar babanë nga kalimtarin i pakujdesshëm i cili kënaqet kur shkel flutura dhe babai ecën ecën nëpër këtë botë që e bën të prekshme vetminë dhe me gjithë kujdesin që ka ndonjë thnegël e pëson prej këmbës së tij duke dështuar në luftën e egër të darvinit për një kënd të padukshëm ngrohtësie

kapërcejnë pastaj nëpër mendjen e babait foljet e ngarkuara me pikëllim për një mijë këngë të lisnajtës që treten pastaj babai ulet sërish në rrënjë të bungut përballë një ketri që kërcen nga imazhi në imazh atëherë visorja e hap faqen e magjisë së saj në dritë të këtij tregimi shfaqen kuqëloret si ombrellat e zanave vendosur nëpër shtigjet kah kalon diana dhe dalin si në shuplakë pikturat e pyllit babai vazhdon udhën vihen në lëvizje mijëra zëre nga frika kur ofshan ai nga pesha e udhëtimit kjo në pyll merret si bori e faunit babai i heq këpucët atëherë dhe i dorëzohet harmonisë së pyllit e koha rrjedh duke sjellë mëngjesin e kuqërremtë harabelat nëpër degëzat e kaçubave dhe të fijeve të barit të gjatë me fara të imta e ndërpresin ëndrrën ia nisin këngës korale dhe bashkë me kandrat e hapin librin e muzikës me tingujt të cilët nga shporta semasiologjike e asaj bote e shpërfaqin hijeshinë e kërpudhave kuqëlore të mijëra e mijëra kuqëloreve që e stolisin pyllin dhe e gjithë kjo do të jetë një poezi e pashkruar e sapfos që është dashur të bëhet himn për mrekullinë e kuqëloreve midis të cilave kalon zbathur në majë të gishtave im atë i mirë dhe të cilat i mbledh e i ruan nimfa në herbariumin prej papirusi e që më vonë do të flasin si një ditar i shkruar shqip.

NARCISI PARA KROIT

narcisi shikon fytyrën e tij në gurrën e kulluar e s'e ka dert se një vashë e ka bërë jehonë e sheh narcisi fytyrën e vet e poshtë në ujë shfaqet një lule me emrin e tij thotë narcisi i dashuruar në vegimin përtej pasqyre tërë kjo bukuri tërë kjo bukuri bukuri e vetme kurse prapa tij ngriten lisat shekullore drunjt me kurora heliodori që prekin kupën e qiellit që ligjërojnë harmoninë e paskajit e fëshfërijnë koha jonë e shkurtër koha jonë e shkurtër më tej një zog i këndon grurit që piqet atje zogu tjetër e zgjon gocën që ka pritur me vite të dashurin të cilin e sjell hera me kurorën e besës

s'i vëren narcisi as fluturat e arta si loznin vallen gazmore mbi kokën e tij keçërit e egër si hanë maja gëmushash s'i sheh i gjori narcis e s'më sheh as mua në dritaren e lartë të kullës si përpiqem ta mbroj nga fytyra e tij grimcën e padukshme të bukurisë derisa era zbulon edhe një bukuri të pyllit përmes pëshpërimës së gjetheve narcisi u tret narcisi u tret

CILËN DEGË TA ZGJEDH

Ndonëse u fut shkrepitimë e rrufesë në dhomë Duke ngrehur pas vetes bubullimën e tmerrshme

Të ma tregojë forcën e urdhit të Zeusit Ec këndej Unë dola e mbeta te bigë e lumit Cilën degë ta zgjedh A të shkoj kah deti Kahut të përunjësisë

A në anën tjetër Në të dajathtë janë radhatur miliona barka të rëndomta

Plot e përplot me udhëtarë të përditshëm Që shkojnë rrafsh rrafsh përfund Zeusit I cili rri i madh përmbi E u fal të gjithëve nga një hallkë ari për qafë Nga një copë tërkuze Shtëpinë e mbyllur Fundin e detit Në anën tjetër shkon degë e lumit drejt

E larg atje në shkëmb i mbërthyer Qëndron kryelartë prometheu që ofron Zjarrin e fjalës Që të djeg rininë e shkabën që t'i ha mushkëritë E mësimin e vështirë si të bëhesh qiri E pak miq

KOT MË VIHET EROSI PRAPA

Erosi është kapur për perden time E nuk hiqet Plot dhomën e ka mbushur me shigjeta Dhe shtatin tim të munduar Larg atje korfuzi i bardhë noton si anije E prej tij ti hedh unazën e premtuar Në shumën e ylbër të detit Përreth shtëpisë së heshtur të babait Lozin tingujt e cicërimave të ëmbëla të trumcakëve Dhe era e luleve të bajameve Po gjithkund Gjithkund hidhëta është e prekshme Me shijen e vetmisë E s'e di pse erosi nuk hiqet se nuk hiqet Nga perdja ime me lule manushaqe

Ndoshta unë jam e vetmja lexuese e tij në rruzull që mendoj se fobitë më të mëdha të këtij shkrimtari vijnë prej kotnisë dhe demotivimit të njeriut perëndimor, se sa prej Islamit... por kjo mbetet për t'u parë nëpër analiza të tjera që do vazhdojnë t'i bëhen pafund veprës së tij si dhe nëpër intervistat e tij tipike, tejet kontradiktore, që vazhdon të japë aty-këtu nëpër media.

Arlinda GUMA

HUELLEBECQ TË PËRKUJTON KOTNINË DHE DEMOTIVIMIN E NJERIUT PERËNDIMOR



tar kontrovers dhe mjaft i debatuar sot në Francë. "Ky djalë ka nevojë vërtetë për 'terapi'...". Ai është i pashërueshëm...". shkruan diku "Washington Post".

Kritikët i kanë evidentuar mungesë stili (letrar) e, nuk duket se e kanë krejt gabim. Nuk mund të thuash se veprat e tij dallohen shumë letrarisht, por historia në vepër, stili, dhe mënyra me të cilën e përcjell ai këtë histori, nuk zënë shumë peshë për shkrimtarin, përqëndrimi i tij më i madh është vëzhgimi i fenomeneve sociologjike të shoqërisë. Një vështrim kronometrikisht i saktë dhe ftohtësisht i shënjestruar drejt e në plagë. E duke qenë i tillë, reagimet kanë përvijuar nga më të egrat e më të pazakontat.

E kanë akuzuar për islamofobi, e kanë akuzuar për nihilizëm, për njëmijë e një gjëra të tjera, por, për mirë apo për keq, opinioni publik gjithmonë e ka mbajtur në qendër të vëmendjes.

HUXLEY NJË NDËR AUTORËT QË KANË FRYMËZUAR HUELLEBECQ-UN

Kur përpara disa viteve mbarova së lexuari romanin "Brave New World", të Aldous Huxley-t, pata një ndjesi të çuditshme mospranimi që s'dija ta shpjegoja mirë ato kohë. E menjëherë pas leximit, më qëllloi që me këdo që flisja për libra, ta përmendja këtë roman qysh në krye të bisedës, madje edhe ta debatoja, derisa në fund arrita të kuptoj se e kisha pëlqyer tepër, por ashtu, ende nën shokun e befasisë, siç na vijnë në jetë të gjithë tepëritë, nuk kisha qenë në gjendje ta kuptoja menjëherë këtë pëlqesë. Dashuria për librat e pazakontë mund të jetë edhe e tillë... Dhe jo vetëm ajo për librat... Dashuria në përgjithësi si koncept mund të jetë edhe e tillë... Qenia njerëzore është më tepër seç duket e koklavitur.

Vonë, shumë më vonë, pas leximit të librit, mësova se Huxley ka qenë edhe një ndër autorët që kanë frymëzuar Houellebecq-un, duke kuptuar njëherazi që këto për-

shtypje të përbashkëta mbi këta autorë, nuk kishin qenë farekrejt rastësore. Ata, edhe pse në kohëra të ndryshme, i kishin dhënë dhe marrë njëri-tjetrit.

Si lexuese, adhuroj kur, përveç kënaqësisë estetike që një shkrimtar i mirë të përcjell me veprën e tij, ai edhe të trazon, të bën të debatosh heshtazi me vete, edhe atëherë kur shkrimtari mund të ketë kohë që ka vdekur. Aq sa të bën ndonjëherë të duash të shkosh t'i flasësh atje te varri; - Ngrihu dhe dili zot atyre që ke shkruar!... I tillë është fati i shkrimtarëve ndonjëherë. E njerëzimi, shpesh tregohet ende i pamatur e i papjekur që t'ia pranojë vetes faktin që, përveç të tjerash, këtë shkrimtar, më e pakta; e merr në konsideratë. Me kohë, konsiderata derivon në pëlqesë apo urrejtje... por sidoqoftë mbetet një konsideratë, fjalë, jo pak e rëndësishme kjo.

Konsiderata ndaj një autori mund të shfaqet në mënyra krejt të pazakonta. Ajo mund të shfaqet edhe me mospranim, debate, linçime publike, madje edhe djegie librash, të cilat, pavetëdijshëm japin ndihmesë të çmuar në pavdekësinë e një libri.

HUELLEBECQ, DUKET SIKUR ËSHTË KUNDËR TË GJITHËVE

Në gjykimin tim si lexuese dhe ri-lexuese e veprës së Houellebecqut, një nga arsytet që ky autor kontestohet kaq zhurmshëm duket fakti që ai nuk kujdeset fare të jetë politikisht korrekt me askënd. Ai duket sikur është kundër të gjithëve. Houellebecq-u nuk ka qenë kurrë politikisht korrekt me Islam, por, ca më pak me qytetërimin perëndimor, këtij të fundit ia ka evidentuar pamëshirë të gjithë zvetënimin, absurdin, boshësinë. Në të vërtetë nuk ka ndonjë rregull të shkruar ndokund ku thuhet se një shkrimtar duhet të kujdeset të jetë edhe politikisht korrekt. Përkundrazi, në këndvështrimin tim, gjithmonë subjektiv, shkrimtarët duhen lënë të lirë për të mos qenë asnjëherë politikisht korrektë.

Vetëm kështu ata i revolucionarizojnë mendësitë, nxisin impulset, risitë e mendimit, novacionin, nxjerrin në pah këndvështrime të panjohura, të pazakonta, që trazojnë keqas kornizat konformiste të shoqërisë, edhe pse për këtë u duhet të paguajnë haraçë kryekëput të kripura.

Houellebecq-un e kanë akuzuar si islamofobik. Por sipas gjykimit tim si lexuese, ai para së gjithash, është një "perëndimoro-fobik". Ai nuk i mban anë perëndimit, madje është fare i pamëshirë me të.

Houellebecq nuk mban qëndrim, ai thjesht konstaton, e në konstatimet e tij, ai nuk bën kurrë kompromise. Ai satirizon, ironizon, më mënyrën e tij të pazakontë, therrëse, logjikëftohtë, asgjësuese. Në romanin "Platforma", gjuha e tij e ashpër ndaj përshkrimit të turizmit seksual të europianëve që kërkojnë ekzotizmin në Tajlandë, nuk është asnjëherë politikisht korrekte.

"Le Monde Des Livres" e ka quajtur romanin "Platforma" një revolucion intim. Michel, një nëpunës i administratës shtetërore franceze (ka gjithmonë një Michel hipotetik, një nëpunës depresiv, në romanet e tij) vendos të bëjë një udhëtim të zakonshëm pushimesh në Tailandë pas një reklame agresive të një agjencie turistike mbi vendin në fjalë. Në këtë butafori, ai do të gjendet herë spektator e herë aktor. Një nëpunës i pamotivuar, i cili do të ndryshojë kur do të bjerë në krahët e një dashurie që do ta shtyjë në zemër të këtij qerthulli, kësaj platforme...

AFTËSIA PËR TË PARË QARTË ABSURDIN E EKZISTENCËS

Kur bisedoja përpara disa kohësh mbi këtë autor, me një ish-kolegen time franceze, bashkëkombase të shkrimtarit, ajo u shpreh me mjaft rezerva. I cilësoi librat e tij si "deprimues". - Sa më pak ta lexosh, aq më mirë, - shtoi pastaj ajo. Ajo shtoi gjithashtu se Houellebecq-u, përveç konstatimeve të hidhura mbi realitetin, nuk di të japë

ndonjë zgjidhje në veprat e tij, por unë mendoj se detyra e një shkrimtari nuk është të japë zgjidhje, shkrimtari nuk është një nëpunës apo menaxher shtetëror...

Më duhet të theksoj se nuk kam ndeshur askund, në asnjë shkrimtar tjetër, një mprehtësi e qartësi vështrimi kaq saktë të shënjestruar. Ndoshta ky është edhe fataliteti i tij. Aftësia për të parë qartë absurdin e ekzistencës. E si rrjedhojë, ai nuk u gjen kurrfarë arsye personazheve të tij për të qenë të lumtur, edhe pse në ndonjë intervistë, çuditërisht është shprehur se beson tek ajo! Ai nuk u gjen kurrfarë arsye personazheve të tij për të parë përreth vetes me entuziazëm. Entuziazmi duhet të jetë fjala më e huaj e të gjithë veprës së tij. (Në veprën e tij ka entuziazëm vetëm atëherë kur i duhet të bëjë ndonjë konstatim therrës).

Në romanin "Zgjerimi i fushës së luftës" (një shtjellim i përvijim të luftës së klasave të Marksit, por vendosur në një sfond të ndryshëm social) ai vizaton ftohtë se si, në ç'përbindësh mund ta shndërrojë individin mungesa e dashurisë.

Janë të njohura tashmë thënie e tij legjendare, tejet sarkastike, mbi bestsellerë si "Kodi i Da Vinçit", mbi aktorë të sheqerosur të Hollywood-it, ndërsa ka një simpati jo fare të padukshme për Agatha Christie-n, dhe në përgjithësi për botën anglosaksonë, e cila dhe e ka pritur më mirë se Franca veprën e tij.

Ndoshta unë jam e vetmja lexuese e tij në rruzull që mendoj se fobitë më të mëdha të këtij shkrimtari vijnë prej kotnisë dhe demotivimit të njeriut perëndimor, se sa prej Islamit... por kjo mbetet për t'u parë nëpër analiza të tjera që do vazhdojnë t'i bëhen pafund veprës së tij si dhe nëpër intervistat e tij tipike, tejet kontradiktore, që vazhdon të japë aty-këtu nëpër media.

Deri atëherë lexues, të sugjeroj ta lexosh këtë autor... E di që gjatë leximit do shtrëngosh grushtat, e do zemërohesh keq me të... Do të duash ta kesh para syve, t'ia fusësh me shpullë e pastaj ta ulësh me forcë përballë teje e të fillosh t'i mbushësh mendjen që jeta nuk është kryekëput ashtu... aq e pabukur; nuk mundet, nuk duhet të jetë aq e kotë, drejt ta hajë!...

Por në fund, një gjë do jetë e sigurt patjetër; në çdo bisedë të mëpasme, ti do të ndjesh nevojën ta citosh... (natyrisht duke i bërë të qartë bashkëbiseduesit që je krejtësisht në oponencë me mendimin e autorit të citimit...)

Houellebecq, ashtu siç te të gjithë ne, do ta ketë bërë ndërkohë tek ty efektin e tij kontrovers...

Haradinaj: Zbatimi i ligjit ishte i pa alternativë meqenëse hyrja ishte ilegale dhe institucionet e rendit i kanë zbatuar procedurat standar. - Serbët paralajmërojnë formimin e AKS. - Mogherini urgjentisht udhëton drejt Beogradit

Prishtinë, 27 mars - Pas dëbimit të Marko Gjuqit nga territori i Kosovës, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj ka thënë se gjendja e sigurisë në vend është e qetë dhe stabile, dhe institucionet e vendit janë në nivel të përgjegjësive në gjithë territorin e shtetit. Haradinaj theksoi se arrestimi i pardeshëm i zyrtarit të Serbisë, Marko Gjuriq nuk ishte veprim i këndshëm, por ishte zbatimi i ligjit. Ai tha se zbatimi i ligjit ishte i pa alternativë meqenëse hyrja ishte ilegale dhe institucionet e rendit i kanë zbatuar procedurat standarde. "E konsiderojmë si situatë standarde të zbatimit të ligjit dhe të të aplikueshme çdo herë në raste të veprimit të ngjashëm", tha kryeministri, transmeton gazeta KOHA.

Mediat e Beogradit njoftuan se menjëherë pas arrestimit të Marko Gjuriqit kanë ardhur edhe reagimet nga Serbia. Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, i shoqëruar nga Marko Gjuriq, kanë pritur në një takim përfaqësuesit e Listës Serbe. Kryetari i Listës Serbe, pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka thënë se Lista Serbe nuk do të jetë më pjesë e Qeverisë së Kosovës.

Përveç kësaj, siç shkruajnë mediat serbe, përcjell Telegrafi, Rakiq ka bërë të ditur se nesër në veri të Mitrovicë do të mbajnë një takim me përfaqësuesit të dhjetë komuneve me shumicë serbe.

"Lidhur me vendimin e autoriteteve shqiptare për largimin e dy diplomateve ruse, na duhet të shprehim keqardhjen për këte rast. Veprimi i pales shqiptare i kundërvihet frymës pozitive për marrëdhënie të mira midis dy vendeve. Pozitën zyrtare ju do të merrni në të ardhmen e afërt." - shprehet zv.ambasadori rus për Reporttv.

Duket se veprimi i Ramës ditën për të larguar diplomatët rusë nga Shqipëria, nuk është pritur aspak mirë nga Rusia.

Ka qenë Zv.Ambasadori i Rusi-

ZHVILLIME DRAMATIKE NË RELACIONIN KOSOVË-SERBI



"Më 20 prill do të formojmë ASK-në, pesë vjet pasi vendimi është marrë në marrëveshjen e Brukselit", ka shtuar Rakiq.

Ai ka vënë në dukje, se për këtë e kanë edhe mbështetjen e Beogradit. Sipas mediave serbe, ministri i Qeverisë së Kosovës, Dalibor Jevtiq ndërkaq ka thënë se vendimi për largimin nga qeveria u miratua njëzëri.

MOGHERINI URGJENTISHT NË BEOGRAD

Ndërkohë Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe për Siguri të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, pritet që vonë pasdite të arrijë në kryeqytetin e Serbisë, Beograd.

Siç raportojnë mediat serbe, ajo, gjatë vizitës së papritur në Beograd, do të ketë takim me pre-

sidentin serb, Aleksandar Vuçiq.

Zëdhënësja e saj Maja Kocijançiq ka thënë se Mogherini "do të shkojë në Beograd në fund të pasdites për të biseduar me Vuçiqin për të ardhmen e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës nën kujdesin e BE-së". Supozohet se një vizitë e tillë e papritur e Mogherinit në Beograd vjen pas zhvillimeve të fundit, përkatësisht pas arrestimit të Marko Gjuriqit në veri të Kosovës, si dhe pas largimit të Listës Serbe nga Qeveria e Kosovës, si dhe paralajmërimi për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe, më 20 prill.

ASNJË KOMANDANT POLICIE S'I KA REFUZUAR UTRDHËRAT

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni gjatë raportimit në Komisionin për

Punë të Brendshme ka folur për arrestimin e djeshëm të drejtorit të zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq. Maxhuni tha se kanë pasur një vendim të Qeverisë për të ndalë hyrjen e Marko Gjuriqit dhe disa zyrtarëve të Serbisë dhe atë vendim e kanë zbatuar. "Ai vendim është ekzekutuar nga njësitë kompetente në pjesën veriore. Ka pas vetëm ndalim-hyrje për Marko Gjuriqin dhe jo ndonjë akuzë tjetër", u shpreh drejtori i Policisë së Kosovës.

Kreu i Policisë gjatë raportimit në Komision ka mohuar se ka pasur refuzim nga komandanti i policisë në veri për të zbatuar urdhrat.

"Me përgjegjësi e them se nuk ka pas refuzim të urdhrave nga komandanti i Policisë në veri, të gjithë kanë qenë në krye të detyrës", u shpreh Maxhuni.

LARGOHET BARRIKADA NË VERI

Barrikada e vendosur mbrëmë në fshatin Rudarë në rrugën Zveçan - Mitrovicë është hequr, dhe trafiku tani po zhvillohet normalisht.

Kjo pengesë ishte vendosur pas arrestimit të drejtorit të të ashtuquajturës Zyre serbe për Kosovën, Marko Gjuriq, njofton Klan Kosova.

Nga atje janë larguar kamionët dhe mjetet e rënda të transportit dhe tashmë magjistralla është zhbllokuar për qarkullim.

"INCIDENTI, REZULTAT I NJË MARRËVESHJEJE NË MES TË BEOGRADIT DHE PRISHTINËS"

Deputetët e Parlamentit të Serbisë janë interesuar sot për arrestimin e djeshëm të Marko Gjuriqit në Mitrovicën Veriore, njofton Klan Kosova. Ata kanë pyetur se cili do të jetë reagimi i shtetit të Serbisë tash pas arrestimit të tij, ndërsa disa nga ta kanë propozuar që negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të marrin fund. Madje sipas tyre incidenti ishte rezultat i një marrëveshjeje në mes të Beogradit dhe Prishtinës, shkruajnë mediat serbe, transmeton Klan Kosova.

Deputetja serbe Marinko Tepiq e ka pyetur kryeministren Anna Bernabiq, se çfarë ka bërë Qeveria pas arrestimit të Marko Gjuriqit, "duke pasur parasysh se ai është zyrtarë i Qeverisë dhe s'ka të bëjë fare me kabinetin e Presidentit", duke iu referuar vendimit të Presidentit Aleksandar Vuçiq që zyrtarët serbë të vijnë Kosovë, transmeton gazeta KOHA.

MOSKA DO TI KUNDËRPËRGJIFJET TIRANËS



së në Tiranë Dmitry Kazmin i cili deklaroi se ndjente keqardhje për heqjen e dy diplomatëve rusë nga ana e qeverisë shqiptare, duke deklaruar se do të jetë koha ajo që do të vërtetojë se veprimi i palës sh-

qiptare ka qenë i gabuar.

Madje Kazmin është shprehur se Rusia nuk e përjashton mundësinë e një kundërpërgjigjeje, një deklaratë kjo e cila në terma të gjuhës diplomatike mund të kon-

siderohet mjaft serioze.

"Lidhur me vendimin e autoriteteve shqiptare për largimin e dy diplomatëve ruse, na duhet të shprehim keqardhjen për këte rast. Ky vendim bie ndesh me perpjekjet tona për permiresimin dhe intesifikimin e marrëdhënieve dypaleshe. Vendimi është i pabazuar dhe koha do ta tregojë këte. Në këte situatë nuk mund të perjashtohen edhe kundersmat nga pala ruse. Edhe njëherë tjetër dua të shpreh keqardhjen për cka ndodhi. Veprimi i pales shqiptare i kundërvihet frymës pozitive për marrëdhënie të mira midis dy vendeve. Pozitën zyrtare ju do të merrni në të ardhmen e afërt." - shprehet zv.ambasadori rus për Reporttv.

Kjo e hënë ka qenë një ditë e ngarkuar politikisht pasi kujtojmë se pas vendimit të SHBA-ve e shumë shteteve të NATO-s për të larguar diplomatët rusë nga vendet e tyre respektive, të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Shqipëria. Shkaku i kësaj lëvizjeje që ka përfshirë dhe shtete të mëdha si Amerika, Britania, Gjermania, Franca etj, është vdekja misterioze e ish agentit rus Sergei Skripal dhe vajzës së tij Yulia.

Vdekja sipas rezultatit të hetimeve ka ardhur për shkak të një agjenti kimik (nervor). Britania, aty dhe ku ka ndodhur vdekja e dy rusëve, akuzon vetë shtetin Rus si organizatorin e fshehur prapa këtij krimi.

TË RINJTË SIRIANË NË TURQI DO TË PËRGATITEN PËR UNIVERSITETE

Të rinjtë sirianë që jetojnë në Turqi do të përgatiten për në universitet përmes një bashkëpunimi nga Komisariati i Lartë i Refugjatëve i Kombeve të Bashkuara (UNHCR), Bashkimi Evropian (BE) dhe Drejtoria e Diasporës Turke dhe Komuniteteve Mike (YTB)



Sipas një njoftimi me shkrim nga YTB dhe UNHCR, projektet "Mbështetje e institucioneve kombëtare në Turqi për lehtësimin e efekteve të krizës së refugjatëve sirianë" dhe "Mbështetje për qasjen e refugjatëve sirianë në Turqi në arsimin e lartë", udhëhiqen me mbështetje financiare nga BE dhe Turqia, transmeton AA.

Projektet në fjalë synojnë rritjen e studentëve sirianë të regjistruar në programet e arsimit të lartë në Turqi. Në kuadër të projekteve, mbi 4.200 të rinjtë sirianë të diplomuar nga shkollat e mesme në vitin akademik 2017-2018 do të fitojnë mundësinë për zotërimin e nevojshëm të gjuhës turke për regjistrim në universitete duke mbaruar programin intensiv të turqishtes brenda një periudhe prej nëntë muajsh. Të rinjtë sirianë në programin falas do të mësojnë të folurit, leximin dhe të shkruarit në gjuhën turke. Kryetari i YTB-së, Mehmet Köse, duke theksuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi, nënvizoi se projektet afatgjate të dedikuara për të rinjtë sirianë në të njëjtën kohë do të jenë kontribut për paqen në botë. "Lufta civile në Siri mund të ketë shkakuar shkatërrime të infrastrukturës që do të marrin kohë të gjatë për t'i riparuar. Megjithatë, një çështje më e rëndësishme

është të sigurohet që të rinjtë sirianë të zhvendosur të mund të shfrytëzojnë më së miri kohën e tyre në vendin pritës, duke menduar gjithashtu për të ardhmen e vendit të tyre", vlerësoi Köse. Ai tërhoqi vëmendjen se popullsia e re në vendet ku ndodhin kriza të tilla cilësohet si "gjeneratë e humbur" për shkak eksperiencave të tyre.

"Megjithatë, me ndihmën e vetëdijshme të bashkësisë ndërkombëtare, mundësitë e arsimit që i ofrohen rinisë siriane në komunitetet pritëse në të cilat jetojnë, do t'i parandalojnë ata nga të qënit 'gjeneratë e humbur'. Përkundrazi, kjo gjë do t'u mundësojë atyre të bëhen 'gjenerata themeluese', të cilat do të jenë e ardhmja e Sirisë. Është e sigurt se arsimi është një nga shtyllat kryesore të paqes rajonale dhe globale në ditët tona", theksoi Köse. Nga ana tjetër, përfaqësuesja e UNHCR-së në Turqi, Katharina Lumpp, është shprehur se dy projektet në fjalë janë shembuj të mirë të bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësi-

ve mes autoriteteve turke, UNHCR-së dhe Delegacionit të BE-së në Turqi.

"Në sajë të këtyre aktiviteteve të përbashkëta, të rinjtë sirianë do të kenë mundësinë për të realizuar ëndrrën e tyre për të shkuar në universitet dhe për të kontribuar në shoqëritë ku jetojnë si zotërues të profesioneve të caktuara", tha Lumpp. Po ashtu, shefi i Delegacionit të BE-së në Turqi, ambasadori Christian Berger, tha se arsimiti është një nga pikat kyçe të mbështetjes së tyre për refugjatët. "Vendimi i Turqisë për heqjen e tarifave akademike për refugjatët sirianë na ka mundësuar zbatimin e projekteve të tilla së bashku me partnerin tonë UNHCR dhe institucionet turke si YTB. Ne besojmë se mundësimi i qasjes së të rinjve në arsim do t'u japë atyre një shans më të mirë për të ndërthtur të ardhmen e tyre", theksoi Berger. Ndryshe, duke strehuar numrin më të madh të refugjatëve në botë, Turqia siguron mbrojtje për më shumë se 3.5 milionë refugjatë sirianë të regjistruar.

"Rusia ndëshkohet pa shkak nga Perëndimi"

"Rusia ndëshkohet pa shkak nga Perëndimi". Ky është reagimi krahasimisht i njësuar për dëbimin e diplomatëve rusë nga shumë kryeqytete perëndimore. Edhe një herë më shumë ministria e Jashtme ruse mohon që ka të bëjë me atentatin në Salisbury. Dëbimi nuk ndihmon në asnjë mënyrë që të gjenden ata që janë fajtorë, thuhet. Ministria ankohet se aleatët e Britanisë së Madhe "e ndjekin verbërisht unitetin euroatlantik" - në kurriz të "arsyes së shëndoshë njerëzore". Qeveria ruse planifikon "kundërmasa të forta", shprehet zëvendësiministri i Jashtëm rus Sergej Riabkov. Moska megjithatë është edhe më tej e hapur për bisedime me SHBA.

Senatori Konstantin Kosaçov, shefi i Komisionit të Punëve të Jashtme në Këshillin e Federatës thotë: Uashingtoni "vendosi të dëbojë 60 diplomatë rusë nga SHBA dhe 60 diplomatë amerikanë nga Rusia", duke nënkuptuar me këtë reagimin e pritshëm rus ndaj dëbimeve. Pasi Uashingtoni e mbylli edhe konsulatën e përgjithshme ruse në Seattle, në shtypin e Moskës bëhen spekulime, se cila nga konsullatat amerikane është në radhë që të ndërpresë punën: ajo në Vladivostok, në Jekaterinenburg ose në Sankt Petersburg.

Juri Shvytkin, zëvendës kryetar i Komisionit të Mbrojtjes të Dumës mendon se konfrontimi kërcënon "stabilitetin global". Konfrontimi është "unilateral" dhe vjen nga SHBA dhe



Në Rusi mendojnë se po i ndëshkojnë pa të drejtë dhe planifikojnë kundërmasa. Që Perëndimi shpall dënime në një kohë kur mbahet zi për viktimat e katastrofës së Kemerovos, kjo është e pakuptueshme për shumë vetë

Britania e Madhe. Deputeti komunist i Dumas Leonid Kalashnikov deklaroi për shkallëzimin e fundit në nivel diplomatik se një gjë e tillë ndodh shpesh para nisjes së një luftime. Evropianët nuk janë në gjendje që ta kapërcëjnë një "ndjenjë solidariteti të kuptuar gabimisht." Politologu Fjodor Lukjanov nuk beson se shkallëzimi i situatës do të marrë fund shpejt. Përkundrazi. Kriza do të acarohet edhe më tej. "Një Luftë e Ftohtë e plotë" është në

prag. As kriza e Ukrainës ose ajo përreth aneksimin të Krimës nuk patën çuar në një acarim të tillë të situatës. Që Perëndimi ka shpallur sanksione të tjera dhe dëbim diplomatik pikërisht në një kohë, kur Rusia mban zi për vdekjen e fëmijëve në Kemerovo, kjo i zëmëron shumë rusë. Tragjedia për rënien e zjarrit është tema më e rëndësishme para të gjitha të tjerave në lajme. Televizioni rus e tregon Putinin në vizitën e të plagosurve në spitale, duke përkujtuar viktimat në murin e qendrës tregtare, në bisedë me qytetarët në Kemerovo. Disa qindra banorë demonstruan dhe u kërkuan autoriteteve që të sqarojnë shkakun e djegies. Presidenti Putin e ka premtuar këtë. Në fund, zëdhënësi i Kremlinit Dimitri Peskov tha se Presidenti do të vendosë se si do të veprojë me dëbimin e diplomatëve të tij.

Shtëpia e Bardhë hedh poshtë pretendimet e Stormy Daniels

Shtëpia e Bardhë u hodh në mbrojtje dhe, pasi natën pararendëse ishte transmetuar intervista me aktoren e filmave pornografikë, Stormy Daniels e cila thotë se ka pasur një marrëdhënie jashtë-martësore me Donald Trumpin në 2006. Aktorja foli për detaje të njohjes së tyre në një intervistë për emisionin "60 Minutes" të rrjetit CBS. Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë Raj Shah u gjend përballë një mori pyetjesh lidhur me Stormy Daniels dhe marrëdhëniet që ajo thotë se ka patur me zotin Trump thuhet 12 vjet më parë. "Për sa i përket intervistës, dua të them se presidenti hedh poshtë qartësisht, me forcë dhe në mënyrë konsistente këto pretendime. I vetmi person që ka bërë deklaratat që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën është ajo që bëri këto akuzat". Në intervistën për dha për emisionin "60 Minutes", aktorja foli me hollësi për marrëdhëniet me zotin Trump që ajo thotë se filluan në 2006. Sipas aktore, në 2011 një person i panjohur iu afrua dhe e kërcënoi për ta bindur të mos fliste publikisht për lidhjet që ajo thotë se ka pasur me zotin Trump. "M'u afrua një burrë dhe më tha: "Mos u merr me Trumpin. Harroje ç'ka ndodhur". Pastaj ai u përkul tek makina, pa nga vajza dhe më tha: "Sa fëmijë i bukur. Do të ishte mëkat sikur e ëma të pësonte diçka të keqe". Pas këtyre fjalëve u largua". Avokati i Stormy Daniels, Michael Avenatti tha për kanal ABC se shpejt do të dalin hollësi të tjera: "Do të ketë plot prova që do të dalin në dritë gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm. Kemi besim se kur të nxirren të gjitha faktet para popullit amerikan, ata do të mësojnë se çfarë ka ndodhur". Në një postim në Twitter të hënën, presidenti përmendi përhapjen e "lajmeve të rreme" por pa komente për intervistën. Miku i presidentit, Christopher Ruddy bisedoi me zotin Trump gjatë fundjavës. "Mund t'ju them atë që më tha ai mua. Ai tha se mendon që akuzat e Stormy Daniels ishin inskenim politik". Ekspertë ligjorë thonë se aktorja Daniels mund të dënohet me gjykojë të rënda pasi ka shkelur marrëveshjen që kishte nënshkruar me avokatin e presidentit për të mos folur për zotin Trump. Por shuma prej 130 mijë dollarësh që avokati i presidentit Michael Cohen i pagoi aktore mund të përbëjë shkelje të rregulloreve për fondet e fushatave të analistit politik David Abraham: "Pagesa për të blerë heshtjen e aktore u realizua, së paku kështu mendohet, përmes fondeve të komisionit për fushatën Trump. Kjo pagesë do të përbente shkelje të rregulloreve pasi komisioni nuk e ka deklaruar këtë shpenzim tek entitetet federale për zgjedhjet". Rrëfimet e aktore janë një tjetër kokëçarje për Shtëpinë e Bardhë ndërkohë që po bëhen ndryshime të rëndësishme në ekipin e sigurisë kombëtare. John Bolton do të zëvendësojë H.R. McMaster si këshilltar i sigurisë kombëtare dhe Mike Pompeo do të marrë detyrën e Sekretarit të Shtetit pas largimit të Rex Tillersonit i cili u shkarkua nga Presidenti Trump.

FERHAT BEJ DRAGA, PRIJËS I LËVIZJES KOMBËTARE TË VITEVE '30 TË SHEKULLIT TË KALUAR (5)

PLANET E PUSHTUESIT SERB



Nga Qerim LITA

Pas pushtimit të Shqipërisë, nga Italia fashiste (7 prill 1939), qeveritarët e Beogradit, duke e shfrytëzuar fatkeqësinë e shtetit Shqiptar, ndër morën masa edhe më radikale, me qëllim siç theksonin: "që njëherë e përgjithmonë ta heqin nga rendi i ditës çështjen shqiptare.". Në kuadër të këtyre planeve, Komanda e Shtatmadhorisë së Armatës hartoi një Memorandum, në të cilin fillimisht përshkruhej disponimi i shqiptarëve nën sundimin jugosllav, pas pushtimit të Shqipërisë, ku sipas tyre gjithnjë e më tepër po e mbështesin politikën italiane. "Shqiptarët - thuhej në memorandum - janë të pakënaqur me gjendjen e tyre aktuale në Jugosllavi. Ky është një fakt të cilin nuk mund ta mbulojmë. Konfiskimin e tokës bujqësore shqiptarëve, si edhe të kuptuarit se ato në territorin tonë janë vërtetë elemente të padëshiruara, gjithsesi se ka ndikuar pozitivisht në zgjerimin e propagandës në favor të Italisë." Kjo gjendje sipas kësaj komande mund të paralizohej në dy mënyra: "ose sa më parë t'i shpërngulim nga territoret tona ose tua plotësojmë kërkesat e tyre në pikëpamje materiale dhe kulturore". Lidhur me këto dy mënyra në memorandum thuhej: "Është e qartë se kjo e fundit ndoshta vetëm përkohësisht do t'i kënaqte, dhe që pastaj në një kohë sa më të afërt dhe në një moment për ne shumë të pafavorshëm, përsëri të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë. Për këtë arsye është nevojë e patjetërsueshme, që me shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje të filloj sa më parë. Kjo sa më parë, sepse në këtë moment shqiptarët janë të dezorientuar, ndërsa marrëdhëniet tona të politikës së jashtme përbal shqiptarëve aq shumë kanë përparësi sa që mundemi të punojmë ashtu siç dëshirojmë ne".

Planet e mësipërme të pushtuesit serb, nuk do të realizohen, falë aktivitetit politiko-organizativ, të parisë intelektuale dhe nacionaliste shqiptare, që njëherë si grupi opozitar i "Bojali Hanit", ku si udhëheqës shpirtëror i tyre qarqet qeveritare serbomadhe e kishin shpallur Ferhat bej Dragën. Në kuadër të këtyre aktiviteteve duhet përmendur takimin e Zenel Strazi-

mirit, Shaban Efendiut dhe Iliaz Agushit me konsullin shqiptar në Shkup, Hamit Kokolarin, i cili, u kishte garantuar atyre, se qeveria shqiptare, nuk do të lejojë në asnjë mënyrë të bëhet depërtimi i dhunshëm i shqiptarëve nga këto treva. Rreth këtij takimi, shërbimet informative jugosllave nga Shkupi njoftonin: "Nga paria shqiptare me ndikim ndërmerren masa, që shqiptarët në vendin tonë (Jugosllavi-Q.L.) të solidarizohen me gjendjen e re të krijuar në Shqipëri. Propagandohet se, për shqiptarët tanë kanë ardhur ditë më të mira". Gjithashtu, në informatë theksohej se: "Konsulli shqiptar në Shkup, gjatë ardhjes së trupave italiane në Shqipëri, ju ka thënë deputetëve të popullit Zenel Strazimirit dhe Iliaz Agushit, se tash për shqiptarët në Jugosllavi do të jetë më lehtë".

Po këto shërbime, vazhdimisht njoftonin për takime dhe mbledhje të shpeshta që organizoheshin nga Ferhat bej Draga me grupin e tij në mbarë territoret shqiptare, në të cilat temë debati ishin, pengimi i shpërnguljes së dhunshme si dhe e ardhmja e çështjes shqiptare. Sipas njoftimit të shërbimit sekret të armatës jugosllave, merret vesh se: "më 4 gusht të vitit 1939 në Prizren kishin qëndruar deputetët shqiptar: Kadri Saliu nga Gostivari, Ilaz Agushi nga rrethi i Nerodimes, Asim Murtezi Luzha nga rrethi i Drenicës, Mustafa Dërguti nga rrethi i Podrimës dhe Zenel bej Strazimiri nga rrethi i Kaçanikut. Ky delegacion shqiptar përveç rrethit të Prizrenit, "vizitoi edhe shumicën e rretheve tjera në Kosovë", gjë që kjo, te kreu më i lartë i armatës jugosllave krijoi përshtypja se këto vizita kanë "prapavijë politike", aq më tepër, që sipas burimeve të tyre: "që nga muaji qershor të këtij viti, në mesin e shqiptarëve tanë vërehet një gjallërim dhe takime të shpeshta të parisë së tyre. Të gjitha këto takime mbahen gjithmonë në mbrëmje dhe vetëm nëpër fshatra", theksohet në fillim të këtij njoftimi, për të shtuar: "Agjentët e Italisë, nëpërmjet lidhjeve të tyre në Shkup, ju kanë parashtruar parisë shqiptare pyetjen: a dëshirojnë ata, që Italia, me kërkesën e tyre, në një moment të përshtatshëm dhe në një afat sa më të shkurtër, të filloj veprimin, që këto vise t'u bashkëngjiten Shqipërisë." "Shqiptarët - vazhdon informatat - nuk kanë dhënë as çfarë përgjigje, por menjëherë fillojnë konsultimet dhe studimin e mendimeve të persona-



Në kuadër të kësaj, gjithnjë sipas këtyre burimeve, Ferhat bej Draga së shpejti kishte udhëtoi për në Stamboll, me ç'rast është takuar edhe me Mbretin Zog, ndërsa nëpërmjet "disa turqve më me ndikim ka arritur të lidhet edhe me disa personalitete të afërta me qeverinë turke". Ferhat Draga gjatë bisedës "i paska premtuar Mbretit Zog, se ai dhe shqiptarët në Kosovë do të ngelin edhe më tutje besnik ndaj tij dhe se do t'i refuzojnë propozimet italiane...

liteteve të shquara shqiptare". Në kuadër të kësaj, gjithnjë sipas këtyre burimeve, Ferhat bej Draga së shpejti kishte udhëtoi për në Stamboll, me ç'rast është takuar edhe me Mbretin Zog, ndërsa nëpërmjet "disa turqve më me ndikim ka arritur të lidhet edhe me disa personalitete të afërta me qeverinë turke". Ferhat Draga gjatë bisedës "i paska premtuar Mbretit Zog, se ai dhe shqiptarët në Kosovë do të ngelin edhe më tutje besnik ndaj tij dhe se do t'i refuzojnë propozimet italiane.

Por, për këtë Mbretin Zog, duhet të veproj te qeveria turke, që të priset konventa e nënshkruar ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë, lidhur me çështjen e shpërnguljes së shqiptarëve nga Jugosllavia. Veç kësaj, dy bashkëbiseduesit kanë ra në ujdë: "Mbretin Zog të veproj mes qeverisë turke dhe demokracisë perëndimore, për rikthimin e tij në Shqipëri, që pas kësaj nga ana e shqiptarëve të Jugosllavisë do të iniciohet bashkimi me Shqipërinë". Në fund të këtij njoftimi thuhet se: "vizita e fundit në Kosovë, nga ana e deputetëve shqiptar ka qenë, gjoja për qëllim, që sa i përket çështjes së bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, e iniciuar nga Italia, tash për tash ti jepet përgjigje negative...".

Rreth qëndrimit të deputetëve shqiptar në Kosovë, njoftonte edhe shërbimi sekret i Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas së cilit: "më 5 gusht 1939, për Gjakovë kanë udhëtuar deputetët e popullit: Asim Luzha nga Drenica, Adem Marmullaku nga Istogu dhe Zenel Strazimiri nga Kaçaniku". Këta në Gjakovë paskan pasur takim me kryetarin e komunës Sulejman Kryeziun dhe me anëtarin e këshillit ekzekutiv të Gjakovës, Ramiz Rizën. Qëllimi i vizitës, kishte qenë: "ngritja e vetëdijes kombëtare te elementi mysliman dhe grumbullimi i të dhënave për çështjen agrare". Deputetët para miqve të tyre kanë deklaruar: "se ata do të kërkojnë te pushtetarët, që të gjithë shqiptarët që ju është marr toka të dëmshpërblehen në para". Po ky shërbim njoftonte për një mbledhje të kërërve udhëheqës shqiptarë, mbajtur në pjesën e parë të shtatorit, ku kishte marrë pjesë edhe Ferhat Draga. Në fjalimin e mbajtur, Draga, paska deklaruar se: "Shqipërisë do t'i bashkëngjiten të gjitha krahinat shqiptare deri në Nish". Ndërkohë. Ministria për Punë të Brendshme, përmes shkresës me nr. 13228, njoftonte se kryetari i Mexhllisit të Ulemasë në Shkup, Sherif Osmani (Langu) "para një kohe qëndroi në Manastir" me ç'rast "ka agjitur në mesin e popullsisë shqiptare, të mos shpërngulen për në Turqi...".

Gjatë kësaj periudhe kohore, strukturat policore e ushtarake jugosllave nga Shkupi, pandërprerë njoftonin për aktivitete të bujshme të kërërve shqiptar në Kosovë e në viset tjera shqiptare nën Jugosllavi, të cilat si synim primar kishin ndërprerjen e tërësishtme të shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga vatrata e tyre për në Turqi. Në kuadër

të kësaj, Komanda e Armatës së III në Shkup, njoftonte Shtabin e Përgjithshëm në Beograd, se paria shqiptare, kohë të fundit po zhvillon një aktivitet të dendur në mesin e popullsisë shqiptare, duke bashkëbiseduar në lidhje me Konventën e arritur midis Jugosllavisë dhe Turqisë: "Nga ato biseda - vinte në dukje Komanda e Armatës së III - shihet se shqiptarët janë shumë të brengosur për shkak konventës për shpërnguljen në Turqi. Udhëheqësit e tyre, në krye me Ferhat bej Dragën, u sugjerojnë që në asnjë mënyrë të mos i lëshojnë vatrata e tyre, sepse pushteti nuk ka rrugë dhe metodë që me forcë t'i shpërngulë...". Më 2 shtator të vitit 1939, Shtabi i Përgjithshëm, njoftonte Ministrinë e Ushtrisë, atë të Punëve të Jashtme, komandantin e Armatës së III dhe komandantin e trupave kufitare, për një raport që i kishte arritur nga ana e Ministrisë për Punë të Brendshme, në lidhje me aktivitetin politik e propagandistik, që kohë të fundit po zhvillohej në Kosovë. Në të vihej në dukje se në ballë të atij aktiviteti qëndronte "Ferhat bej Draga, ish-deputet nga Mitrovica e Kosovës", i cili, siç thuhej "është udhëheqësi ideor i mbarë popullsisë nga këto vise". Ai, theksohej në vazhdim të dokumentit "para pak kohësh, i ka porositur miqtë e tij, se beson që Italia në një kohë sa më të shkurtër do t'i marrë këto vise, që deri atëherë shqiptarët duhet të kenë durim dhe të presin momentin e përshtatshëm për realizimin e qëllimeve të veta...".

Gjatë muajve shtator-tetor 1939, një aktivitet të dendur pati edhe Mexhllisi i Ulemasë së Shkupit, ku një delegacion i lartë i udhëhequr nga Bedri Hamidi, vizitoi të gjitha qendrat më të rëndësishme që i përkisnin këtij mexhllisi, si: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Preshevë, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Strugë, Ohër, Manastir, Ulqin, Novi Pazar etj., me ç'rast u mbajtën ligjëratat me karakter fetar, kombëtar e politik nëpër xhamitë kryesore të këtyre qendrave. Nga tërë ky aktivitet, përmes një raporti të detajuar prej 59 faqesh, Mexhllisi i Ulemasë, njoftonte udhëheqësin supreme të BFI-së në Sarajevë, Reis-ul-Ulemanë Fehim ef. Spahon, për gjendjen e mjerueshme të popullsisë shqiptare-muslimane, për shkak, siç vihej në pah, politikës diskriminuese të pushtetit serbomadhe. "Reforma agrare - thuhej në raport - e cila përbënte shkaku kryesor për varfërimin e të gjitha shtresave myslimane dhe i detyronte për t'u shpërngulur, në përgjithësi pati pasoja shumë të rënda.



Nga Agim RUSHITI

PËRGJEGJËSI PËR FINANCIM TË ARSIMIT TË LARTË

Mirëmbajtja e institucioneve të arsimit të lartë dhe instituteve shkencore, si përgjegjësi publike, implikon pa mëdyshje një shkallë të lartë të përgjegjësisë për të ardhmen e zhvillimit, në planin e zhvillimit shoqëror dhe individual dhe i zhvillimit të mendimit shkencor. Kjo nënkupton: Përgjegjësi për financim të arsimit të lartë; Përgjegjësi për qasje participative në kreimin e politikave në arsimin e lartë dhe Përgjegjësi për qasje participative në zhvillimin e programeve studimore.

Në aspektin e financimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, Ligji i ri i arsimit të lartë siguron financim të veprimtarisë së arsimit të lartë dhe të hulumtimit shkencor nga ana e shtetit, në mënyrë adekuate, stabile, të garantuar, stimulative, integrale dhe të pakushtëzuar. Kjo nënkupton ndryshimin e mënyrës së financimit të procesit mësimor dhe atij hulumtues-shkencor, për qëllim të sigurimit të një procesi funksional, që rrit kuptimësinë e autonomisë financiare të universiteteve, duke ofruar opsionin e zgjerimit të mundësive për gjetjen e burimeve tjera financiare, duke siguruar gjatë kësaj ex post llogarillënie adekuate, përmes garantimit se institucionet e arsimit të lartë dhe institutet shkencore të jenë njëkohësisht edhe njësi buxhetore, por edhe njësi financiare.

Në funksion të sigurimit të sistemit adekuat të financimit të arsimit kualitativ të lartë, Ligji i ri i arsimit të lartë siguron: Model të ri të financimit të procesit të mësimin dhe atij hulumtues-shkencor, në drejtim të realizimit të një procesi funksional, të qëndrueshëm, real, kompetitiv dhe kualitativ; Krijimin e mekanizmave për financim të qëndrueshëm të veprimtarisë së arsimit të lartë dhe atij hulumtues shkencor; Lirimin nga tatimi për disa aktivitete specifike që zhvillon institucioni i arsimit të lartë, që ofrohen në formë donacioni; Standard të qëndrueshëm të studentëve që nënkupton edhe të drejtën për subvencionim të shkollimit; Subvencionim për vendosje në konvikte dhe për ushqim, sigurim shëndetësor, mundësi për punësim të përkohshëm dhe të drejta të tjera të veçanta për një kategori studentësh; Financim të studimeve për një kategori studentësh me gjendje të rëndë sociale; Financim të studentëve të dalluar për nga talenti, të cilët plotësojnë kushte të përcaktuara me ligj, për të tri ciklet e studimit; Financim të veprimtarisë botuese të universiteteve dhe parapagimin e rrjeteve të kërkimit shkencor që sigurojnë kualitet në



Ligji i arsimit të lartë i kushton kapitull të veçantë studentëve, si anëtarë të barabartë të bashkësisë akademike. Aty janë të definuara të drejtat e studentëve, obligimet e tyre për gjatë studimeve, standardi i studentëve dhe organizimi i jetës studentore, kriteret dhe mekanizmat të cilat e garantojnë pavarësinë në raport me reprezentativitetin dhe promovimi i mundësive për veprim të organizuar kolektiv dhe masovik në sferën akademike, shoqërore dhe atë politike

arsimin e lartë; Financim kompetitiv të projekteve hulumtuese; Përkrahje financiare për qasje deri te kapacitetet hulumtuese të kompanive të locuara brenda dhe jashtë vendit.

Për realizimin e financimit të tillë të veprimtarisë në arsimin e lartë parashihet edhe ndryshimi i "Rregullores për masat dhe kriteret për financimin e institucioneve të arsimit të lartë" dhe akteve tjera nënligjore.

Në funksion të sigurimit të stabilitetit juridik dhe atij financiar të universiteteve, Ligji i ri i arsimit të lartë parasheh formimin e trupit të pavarur profesional, Këshillit nacional për arsim të lartë, i cili është përgjegjës ta rregullojë veprimtarinë e sistemit të arsimit të lartë, përveç tjerash, edhe në aspektin financiar.

Në aspektin e Përgjegjësisë për qasje participative në kreimin e politikave në arsimin e lartë, Ligji i ri për arsim të lartë parasheh kyçe aktive të të gjithë faktorëve që janë të involvuar në procesin e arsimit të lartë dhe të të gjitha trupave dhe organeve që janë plotësisht të autorizuar në kreimin e politikave dhe

sjelljen e vendimeve në arsimin e lartë.

Në aspektin e Përgjegjësisë për qasje participative në zhvillimin e programeve studimore, Ligji i ri i arsimit të lartë definon mekanizma për pjesëmarrje aktive të të gjitha palëve që janë të lidhur me procesin e arsimit të lartë, në veçanti të bashkësisë së biznesit, në zhvillimin e programeve studimore dhe atyre lëndore. Gjatë kësaj, në kreimin e programeve studimore, logjika e implementimit të interesave të dala nga kërkesat e tregut të lirë, nuk nënkupton ekskluzivitet në dëm të marginalizimit të komponentave, participantëve dhe interesave të ushtruese të veprimtarisë së arsimit të lartë dhe të vetë veprimtarisë.

Sa i përket Kualitetit në arsimin e lartë, si një komponentë mjaft me rëndësi të cilës i kushtohet vëmendje e veçantë në Ligjin e ri për arsimin të lartë, në vehte sublimon standarde, procedura dhe mekanizma për sigurimin e cilësisë, të cilat aplikohen edhe në Hapësirën e përbashkët të arsimit të lartë, të definuara nga ana e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, ENQA (European Association for Quality Assurance in Higher Education). ENQA është një organizatë ombrellë e cila përfaqëson organizatat e sigurimit të cilësisë nga shtetet anëtare të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, EHEA (European Higher Education Area). ENQA promovon bashkëpunimin evropian në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe shpërndan informacionin dhe ekspertizë midis anëtarëve të vet dhe ndaj palëve të interesuara, në mënyrë që të zhvillojë dhe të ndajë praktikatat e mira, si dhe të nxisë dhe ndihmojë dimensionin evropian të sigurimit të cilësisë.

Komponenta tjetër mjaft me rëndësi e cila është prezentë në Ligjin e arsimit të lartë është Konso-

lidimi i hulumtimit, si pjesë përbërëse e arsimit të lartë. Hulumtimi dhe performancat hulumtuese të stafit akademik janë prezentë në dispozitat e ligjit dhe ato shkojnë në drejtim të afirmimit të kapaciteteve hulumtuese të stafit akademik, avancimin shkencor të tyre dhe të mirat që dalin nga një angazhim i tillë i tyre (për Ta dhe për shoqërinë). Ky ligj lejon që institucionet e arsimit të lartë lirshëm të përcaktohen si institucione arsimore, arsimore-hulumtuese dhe si arsimore – shkencore - hulumtuese.

Statusi, struktura dhe drejtimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe i njësive përbërëse të tyre, sipas Ligjit të ri të arsimit të lartë parashihet të jenë të orientuara në drejtim të integritetit funksional, për një pjesë të detyrimeve dhe kompetencave, por me shkallë të lartë të lirisë të njësive (fakulteteve), në pjesën e disponueshmërisë së mjeteve vetanake, në drejtim të zhvillimit të specifikeve të veta si njësi përbërëse të universiteteve dhe në autonominë e vendimarrjes, për çështje me rëndësi nga veprimtaria arsimore-shkencore, hulumtuese, artistike dhe profesionale-aplikative. Struktura drejtuese e institucioneve të arsimit të lartë dhe atyre hulumtuese-shkencore, në këtë zgjidhje ligjore që është në draftversion, mëton ta plotësojë kushtin e respektimit të principit të demokracisë, sidomos në pjesën e vendimarrjes. Në këtë segment është vendosur struktura e cila mundëson, numër më të madh të subjekteve, mbi bazë të partneritetit, kyçe në procesin e dhënies së propozimeve dhe në vendosje, duke përfshirë edhe studentët (si pjesë e bashkësisë akademike), si edhe është vendosur mekanizmi për ndalimin e koncentrimin të lartë të fuqisë në individ dhe në strukturat të caktuara (rektor, dekan, shef katedre,...), ndarjen e roleve dhe

përgjegjësi për të gjithë faktorët e involvuar në veprimtarinë e arsimit të lartë dhe atij shkencor-hulumtues. Ligji i ri i kyç studentët si partner të barabartë në vendimarrje, në organet dhe trupat e institucioneve të arsimit të lartë dhe me këtë kontribuohet në realizimin e interesave të studentëve dhe në forcimin e bashkësisë akademike, e nga ana tjetër nxit kultivimin e vlerave dhe praktikave demokratike.

Duke pasur parasysh se veprimtaria e arsimit të lartë dhe hulumtimi shkencor është, në masë të madhe, i varur nga kualiteti i programeve studimore dhe atyre lëndore që ofrohen për studentët, në Ligjin e ri të arsimit të lartë, ato zënë vendin me rëndësi në bordinë e shtjellimit të saj. Struktura, organizimi, vëllimi, lloji, kohëzgjatja dhe vlerësimi përmes kredivë i programeve të reja studimore dhe atyre lëndore duhet të përkojë me sugjerimet e dala nga Deklerata e Bolonjës, respektivisht nga vetë Procesi i Bolonjës si tërësi. Programet studimore në Republikën e Maqedonisë, sipas Ligjit të ri të arsimit të lartë, duhet t'i pasqyrojnë specifitetet e sistemit tonë të arsimit të lartë, por edhe të jenë të krahasueshme me programet e ngjajshme studimore nga Hapsira e përbashkët evropiane e arsimit të lartë. Kjo veçanërisht i përket programeve të profesioneve të rregulluara, si parakusht për pranimin e ndërsjellët të kualifikimeve profesionale mes vendeve të ndryshme.

Ligji i arsimit të lartë i kushton kapitull të veçantë studentëve, si anëtarë të barabartë të bashkësisë akademike. Aty janë të definuara të drejtat e studentëve, obligimet e tyre për gjatë studimeve, standardi i studentëve dhe organizimi i jetës studentore, kriteret dhe mekanizmat të cilat e garantojnë pavarësinë në raport me reprezentativitetin dhe promovimi i mundësive për veprim të organizuar kolektiv dhe masovik në sferën akademike, shoqërore dhe atë politike. Në këtë ligj të ri, parashikohet formimi i Kuvendit universitar të studentëve, si trup i veçantë i universitetit, ku anëtarë të saj janë përfaqësuesit e studentëve. Ky kuvend studentor i mbron interesat e studentëve dhe përmes përfaqësuesve të vet merr pjesë në vendimarrje, në organet dhe trupat e universitetit, për qëllim të realizimit të të drejtave në interes të tyre dhe të arsimit të lartë në përgjithësi.


(vijon në numrin e ardhshëm)

Koha, e martë 28 mars, 2018

STRAKOSHA E RAMADANI FLASIN PËR SFIDËN ME NORVEGJINË

LUAJTËM DISI ME FRIKË, POR ISHTE NJËLLOJ EKSPERIMENTI

Diferencat nuk ishin shumë të mëdha, por ata ishin më të organizuar taktikisht dhe fizikisht. Ne luajtëm disi me frikë, por ishte edhe një lloj eksperimenti, pasi kishim shumë lojtarë të rinj në fushë. Normalisht, për lojtarët e rinj është e vështirë që të japin maksimumin qysh në takimin e parë. Gabova edhe unë shumë topa sot, por prandaj janë miqësoret, për të mësuar më mirë lëvizjet dhe pozicionet e njëri-tjetrit", shprehet Strakosha



tikisht dhe fizikisht. "Diferencat nuk ishin shumë të mëdha, por ata ishin më të organizuar taktikisht dhe fizikisht. Ne luajtëm disi me frikë, por ishte edhe një lloj eksperimenti, pasi kishim shumë lojtarë të rinj në fushë. Normalisht, për lojtarët e rinj është e vështirë që të japin maksimumin qysh në takimin e parë. Si mund të evitohet goli? Vetëm me përqendrim, pasi në ato momente e kishim ulur ritmin dhe humbëm edhe vëmendjen. Jo vetëm ky gol, por çdo rast evidentohet me përqendrim. Gabova edhe unë shumë topa sot, por prandaj janë miqësoret, për të mësuar më mirë lëvizjet dhe pozicionet e njëri-tjetrit", u shpreh Strakosha. Në anën tjetër, Ramadani, i cili debutoi për Kombëtarën më të mirë, thotë se atij dhe tre futbollistëve tjerë Bare, Qaka dhe Lika, të cilët gjithashtu debu-

NË QERSHOR KUNDËR UKRAINËS

Shqipëria do të luajë kundër Ukrainës një nga miqësoret e programuara për muajin qershor, kur mund të luhen disa takime përgatitore nga skuadrat që marrin pjesë në Kampionatin Botëror. Por ndryshe nga sa ishte planifikuar, Shqipëria nuk do të luajë kundër një pjesëmarrëseje në këtë aktivitet, por kundër një skuadre e cila ashtu si kuqezinjët, përfunduan në vendin e tretë në grupin kualifikues. Skuadra e drejtuar nga Andriy Shevchenko përfundoi pas krahëve të Islandës dhe Kroacisë, në grupin në të cilin ishte pjesë edhe Kosova, ndërsa kërkon që të sigurojë pjesëmarrjen në Euro 2020.

tuani, u nevojitet pak kohe për t'u harmonizuar dhe për t'u bërë pjesë e ekipit. "Norvegjia dhe Danimarka kanë një futboll të përafërt. Besoj se e prisja këtë lojë të kundërshtarit, por më vjen keq që nuk morëm rezultat. Edhe ne patëm mundësitë tona dhe po të kishim shënuar me Ajetin, do të flisnim ndryshe. Gjithsesi, unë, Bare, Qaka dhe Lika luanim për

herë të parë dhe normalisht që na duhet pak kohë për t'u harmonizuar dhe për t'u bërë pjesë e ekipit. Kjo ishte ndeshja ime e parë me Shqipërinë dhe normalisht më duhet ende kohë për të arritur të shprehem mirë. Gjithsesi, me kalimin e kohës do të arrijmë të bashkëpunojmë më mirë dhe të shprehemi më mirë", u shpreh Ramadani.



Jashari, xhudisti numër një në listën për LO në Argentinë

Shkup, 27 mars - Hamza Jashari është i pari në renditjen e Unionit të Federatës Evropiane të Xhudos në kualifikimet për Lojërat Olimpikë në Buenos Aires të Argentinës, bën të ditur "ipon.mk", transmeton gazeta KOHA. Cekim, xhudisti shkupjan në afat prej tre muajve, arriti të fitojë dy medalje të arit dhe një të argjendtë në Kupat Evropiane, diçka që deri më tani nuk i kishte ndodhur xhudos në Maqedoni. "Kontributi nga stërvitjet e rregullta dhe përkushtimi po dalin në sipërfaqe. Ndihej mirë për tatamet dhe me padurim i pres luftërat tjera. Për rezultatet e mira meritator janë sparing partnerët dhe ekipi që po punon me mua, trajneri im Igor Paskovski dhe eksperti i IGF Gabriel Sapt. Kam mbështetje të madhe nga familja, klubi im 'Mioki' dhe sigurisht, Federata e Xhudos në Maqedoni", deklaroi Hamza Jashari për "Ipon.mk", transmeton KOHA. Ndërkaq, deri më tani Hamza Jashari dhe Anamarija Georgievska (takevondo) janë pretendentët më serioz (të sigurt) për pjesëmarrje në Lojërat Olimpikë për junior.

Java e 25 shtyhet për të dielën



Shkup, 27 mars - Komisar për Gara pranë Federatës Futbollistike të Maqedonisë, të martën ka ndry-

shuar edhe një herë orarin e ndeshjeve të elitës së futbollit vendor. Pasi të hënën u vendos të shtyhen

ndeshjet Skopje-Shkëndija dhe Pelisteri-Vardari, për shkak të paraqitjes së më shumë futbollistëve nga kampionati vendor në përfaqësueset e Maqedonisë (A dhe shpresat), tani është vendosur që megjithatë të shtyhet gjithë kompleti xhiroja e 25-të, e cila duhet të luhet të enjten. Kështu të enjten nuk do të ketë futboll elitare dhe gjithë ndeshjet e xhiros së 25-të janë shtyrë për të dielën (1 prill), kur në program do të jenë pesë përballje, derisa ndeshjet e xhiros së 26-të që paraprakisht ishin caktuar të luhen të dielën, janë shtyrë për të shtunën e ardhshme (7 prill).

Aliji, pjesë e historisë së Virtus Entella

Shkup, 27 mars - Mbrojtësi i kraut të majtë i kombëtares shqiptare Naser Aliji, nga ndeshja e së hënës mes Shqipërisë dhe Norvegjisë (0-1), është bërë pjesë e historisë së skuadrës italiane Virtus Entella. Kumanovari bëhet futbollisti i parë i kësaj skuadre që ka luajtur në një ekip kombëtar. Për këtë fakt kjo skuadër në faqen e saj zyrtare ka shkruar se kjo paraqet një sukses të madh për Virtus Entella, por se edhe në kohë të njëjtë është burim krenarie dhe kënaqësi për të gjithë anëtarët e saj. Virtus Entella, për këtë arritje të Naser Aliji, ka shkruar një artikull në faqen e tyre zyrtare të internetit. Ndryshe, Aliji ndaj Norvegjisë luajti 90 minuta.



UEFA NDRYSHON LIGËN E KAMPIONËVE

MË SHUMË LOJTARË DHE MË SHUMË ZËVENDËSIME

Do të thotë se ky rregull do të mund të shfrytëzohet vetëm pas fazës me grupe. Gjithashtu, ekipet do të kenë mundësinë të kenë 12 lojtarë në stol në finale. Sistemi i ri kualifikues është konfirmuar tashmë, me katër ekipet e para të kampionateve kryesore të Evropës që do të kalojnë direkt në fazën me grupe



firmuar tashmë, me katër ekipet e para të kampionateve kryesore të Evropës që do të kalojnë direkt në fazën me grupe.

Dje janë lajmëruar ndryshimet e tjera për sezonin e ardhshëm, me një zëvendësim ekstra që do të mund të bëhet në ndeshjet që kalojnë në shtesë. Për finalen e Ligës së kampionëve, Liga Evropës dhe Superkupën e Evropës, skuadrat do të lejohen të grumbullojnë 23 lojtarë. Kjo do të thotë se trajnerët do të kenë 12 lojtarë në stol nga të cilët mund të zgjedhin, gjë që ndodh aktualisht në Serinë A. do të ndryshojnë edhe oraret e ndeshjeve, që do të luhen në orën 21:00 dhe jo më 20:45. Megjithatë, në çdo javë të fazës me grupe dy nga ndeshjet e të martës dhe të së mërkurës do të luhen në orën 18:55, ndërsa të gjitha ndeshjet e javës së fundit të fazës me grupe do të luhen në të njëjtën orë.

UEFA ka lajmëruar ndryshimet që do të pësojë Liga e kampionëve dhe Liga Evropë. Duke filluar nga sezoni i ardhshëm, skuadrat do të kenë mundësi të bëjnë një zëvendësim të katërt në kohën shtesë. Kjo do të thotë se ky rregull do të mund të shfrytëzohet vetëm pas fazës me grupe. Gjithashtu, ekipet do të kenë mundësinë të kenë 12 lojtarë në stol në finale. Sistemi i ri kualifikues është kon-



Portieri urinion në portë

Portieri i Messinas Armando Prisco ka dalë me karton të kuq në derbin sicilian ndaj Igea Virtus pasi urinoi në portë. Portieri nuk mund ta mbante dot më gjatë minutave të fundit të ndeshjes së Serie D. "Unë pi 2-3 litra ujë në ditë", shprehet 21-vjeçari. "Piva ujë për të parën herë kur erdhëm në stadium më pas gjatë nxehtësisë, edhe njëherë tjetër në dhomat e zhveshjes dhe gjatë pushimit. Nuk mund ta mbaja më. Po mundohesha të lëvizja rreth e rrotull por dukesha si i çmendur. Kështu që sapo pashë që ndeshja u ndal për një zëvendësim, u mundova të shfrytëzoja situatën. Pretendova sikur po bëja hapje pas reklameve dhe askush nuk e kuptoi, përveç arbitrit fatkeqësisht. Menjëherë kërkova falje dhe nuk protestova, pasi i di rregullat. E kuptoj se kishte shumë fëmijë në stadium dhe u mundova të fshihja veprimin tim. Nuk ishte gjëja e duhur për t'u bërë por nuk e mbaja dot më", deklaroi Prisco.

Mejveder nis javën e ardhshme stërvitjen në kafaz

Në dhjetor, Floyd Mejveder deklaroi se ka marrë një ofertë nga UFC-ja për të provuar një eksperiencë të re në artet marcialë mikse, duke zhvilluar disa duela dhe për të fituar një shumë prej 1 miliardë dollarësh. Ndërkohë që, javën e kaluar kampioni amerikan i boksit deklaroi se së shpejti do të niste stërvitjen për një duel të mundshëm në kafaz, duke premtuar se pas 6 apo 8 muajsh, do të ishte gati. Koha e nevojshme që i duhet edhe për të marrë licencën për të dueluar në kafaz dhe për të debutuar në MMA. Sot duket se gjithçka është e vërtetë dhe gati

për këtë debutim, pasi Tajron Voodlej, kampioni i botës në peshën "welter" u shpreh se do të nisin së bashku stërvitjen gjatë kësaj jave. "Kam folur dje me Floyd, aktualisht është në Majami dhe sapo koordinuam datat për t'u stërvitur së bashku. Do të nisim procesin stërvitor, që fillimisht do të jetë si një lojë strategjike me telefon, pasi në MMA duhet të përgatitesh për disa disiplina sportive, si mundje, për goditje me shkelm, për jiu-jitsu, xhudo etj. Floyd i ka parimet bazë të shumë sporteve, të cilat ka nevojë t'i kombinojë me aftësitë e tij të boksimit.

Publicitet

MERCEDES PRANON FAJIN



Llogaritëm gabim distancën me Fettelin

"Çfarë ndodhi? Përse Fettel është përpara meje? Mos kam gabuar unë?", kanë qenë 3 pyetjet që piloti britanik Luis Hamilton i bëri skuadrës Mercedes gjatë komunikimit me radio në momentin që Sebastian Fettel me Ferrari doli para tij pas ndërrimit të gomave. Pyetje legjitime të kampionit të botës, që deri në ato momente po komandonte garën dhe po parashikonte një fitore të lehtë në Çmimin e Madh të Australisë. Por më pas u kuptua se i gjithë faji ishte i drejtuesve të Mercedes, që kishin bërë gabim llogaritëm në momentin që në pistë hyri "makina e sigurisë virtuale". Këtë gjë e pranoi sot drejtori sportiv i Mercedes, Toto Wolff, që tha: "Gara nisi mirë, por me një makinë është e vështirë të bësh një stra-

tegi të mirë. Pas nesh, Raikkonen bëri një ndalesë për gomat dhe ne vendosëm ta mbulonim, duke futur Hamilton. Më pas, sistemi na tha se kishim një avantazh të sigurt për të qenë të parët edhe pse Fettel s'kishte hyrë. Por nga monitori pamë që sistemi ynë kishte gabuar. Duhet të kuptojmë se përse ndodhi kjo gjë, tha Wolff. Për sa i përket garës së Bottas, shefi i makinës gjermane shprehet: "Kur e nis garën nga vendi i 15-të është e vështirë të bësh një paraqitje të mirë, në një pistë ku është e vështirë të parakalosh. Gara e Luis? Pasi bëri 30 xhiro pas Fettel është normale që në fund do të tërhiqesh, pasi duhej të menaxhonte gomat, por nuk patëm asnjë problem me makinën".

Organizata humanitare Ogranok na M.I.H.O. Tetovë, në bazë të vendimit IS/2018/8-1 bën shpallje publike për ndërmarrjet që merren me tregti të produkteve ushqimore, për dorëzimin e ofertave për paketa me produkte ushqimore në kuti prej kartoni në dimensione të përshtatshme për të pakëtuat përmbajtjen e pakos si vijon në bashkëngjitjen më poshtë.

Artikujt ushqimorë për projektin Ramazani 2018

nr	Artikulli ushqimor	Marka	Sasia (kg/litar)	Çmimi për kg	total
1	Miell		5KG		
2	Vaj Ushqimor		3Litra		
3	Sheqer		3 copa 0.9 kg		
4	Oriz		5 copa 0.9 kg		
5	Krip		1kg		
6	Fasule		2 copa 0.9 kg		
7	Makarona		6 copa 0.35 kg		
8	Fide		2 copa 0.40 kg		
	Gjithsej				

Sasia e pakove është afër 1500 copë. Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësohen nga ana e kompanive që do të dorëzojnë ofertat janë: Çmimi duhet të jetë me transport deri në destinacionin e caktuar sipas nevojës ku do të bëhet shpërndarja e pakove shfrytëzuesve. Vendosja e Logos së Organizatës nëpër pakot e ushqimit. Koha e realizimit Maj 2018. Për detaje të tjera tel. kontakt (044/332-554). Ofertat të dërgohen në adresën Ogranok na MIHO Tetovë. Rruga 134, Nr 12, në Tetovë me rekomandim në afat deri më 29.03.2018.

Nga Drejtorja

OPERACIONI
"RAFINHA"

INTERI KËRKON ULJE TË ÇMIMIT NGA BARCELONA

Siç raportohet nga "Corriere dello Sport", qëllimi i zikaltërve do të jetë për të marrë një zbritje nga klubi katalanas. Në vend të shifrës prej 38 milionësh, 30 prej tyre do të paguhen, me një shlyerje që do të kryhet edhe pas 30 qershorit, në mënyrë që të mos bjerë bar mbi buxhetin aktual dhe të llogaritet si operacion në atë që ka të bëjë me sezonin 2018-2019

Mesfushori brazilian ka qenë në gjendje të bashkojë duart me zikaltrit në një kohë të vështirë dhe Luçiano Spaletti e ka zgjedhur atë një nga udhëheqësit e ekipit, pavarësisht se mbërriti vetëm në janar. Për këto arsye, shlyerja nga Barcelona është një hipotezë e vërtetë. Në rast të kualifikimit në Ligën e Kampionëve, Interi do të

duhet të paguajë 35 milionë, plus 3 milionë bonuse në arkat Blaugrana, të gjitha para fundit të qershorit. Nga ana e tij, klubi i Seria A do të donte për të rinegociuar kushtet e marrëveshjes, për ta bërë atë më të qëndrueshme në funksion të "Fair Play Financiar". Siç raportohet nga "Corriere dello Sport", qëllimi i zikaltërve do të

jetë për të marrë një zbritje nga klubi katalanas. Në vend të shifrës prej 38 milionësh, 30 prej tyre do të paguhen, me një shlyerje që do të kryhet edhe pas 30 qershorit, në mënyrë që të mos bjerë bar mbi buxhetin aktual dhe të llogaritet si operacion në atë që ka të bëjë me sezonin 2018-2019. Tani për tani, Barcelona nuk duket e

gatshme të merret me kësi skenarësh, edhe pse kontaktet mes dy klubeve janë të shpeshta dhe raportet më shumë se të mira. Interi do të ndikojë në vullnetin e Rafinjas, që sapo ka deklaruar dashuri për zikaltrit me një histori në "Instagram", duke e bërë të qartë se dëshira e tij është të qëndrojë në Milano në të ardhmen.



Bajerni "bind" Tuçel të refuzojë Arsenalin

Tomas Tuçel duket se do të refuzojë ofertën e Arsenalit për të marrë drejtimin e Bajern Mynihut. Gjermani ka zëvendësuar Jurgen Klopp te Borussia Dortmund dhe ka kaluar dy vite në drejtim të verdhezinjve para se të shkarkohej majin e kaluar, vetëm tri ditë pasi fitoi Kupën e Gjermanisë. Që nga ajo kohë, ai është folur për kalime të mundshme te Arsenali, Çellsi dhe Bajern Mynih. E ardhmja e Arsene Wenger në "Emirates" është në dyshim pas një tjetër sezoni zhgënjyes dhe francezi mund të largohet në fundin e këtij sezoni. Ndërkohë, javën e kaluar u tha se Tuçel kishte refuzuar bavarezët dhe po priste të bëhej zëvendësuesi i trajnerit të Arsenalit. Tani, sipas "Sky Sports", është zbuluar se ai nuk ka pasur asnjë kontakt me "Topçinjtë" dhe synon të marrë drejtimin e kampionëve në fuqi të Gjermanisë, të cilët drejtohen nga Hejnkës, por ky i fundit ka bërë të ditur se do të largohet në fundin e sezonit. Tuçel është zgjedhja e parë e Bajernit, ndërsa alternativa quhet Maurisio Pochettino.



Siti e ka gati ofertën për Iskon

Mançester Siti ka filluar të mendojë që tani për merkaton e verës, ku një nga dëshirat e trajnerit Guardiola, është ylli i mesfushës së Realit, Isko. Sipas mediave angleze, "qytetarët" janë të gatshëm të paguajnë një shifër, që kap vlerën e 75 milion sterlinave, për të siguruar shërbimet e 25-vjeçarit. Gjatë merkatoeve të kaluara, "qytetarët", kanë pretenduar edhe dy herë të tjera të Iskon, por që ofertat e anglezëve janë

hedhur poshtë nga madrilenët të cilët duan ta mbajnë në skuadër mesfushorin. Aktualisht, Isko përfiton rreth 140 mijë sterlina në javë, ndërkohë që në Angli kjo shifër do të rritej dhe mundësia për të nisur ndeshjet si titullar do të ishte më e madhe. Mançester Siti duhet të përballë Arsenalin dhe Mançester Junajtidin për Iskon, pasi të dyja këto ekipe janë të interesuara për ta transferuar në Angli.

Arjen Robben mund të transferohet te Beshiktashi

Arjen Robben është në mëdyshje për të ardhmen e tij. Holandezit i mbaron kontrata në verën e ardhshme dhe te Bajern Mynih ende nuk ia kanë bërë ofertën për rinovim. Edhe pse nisur nga kontributi i madh që mesfushori ka dhënë, dëshira e drejtuesve të klubit është që të rinovojnë sërish. Mirëpo ky hezitim ka ndikuar te Robben, i cili priste që ta kishte ofertën deri më tani. Për më tepër që ka ekipe të interesuara për shërbimet e 34 vjeçarit, që janë gati t'i bëjnë atij oferta mjaft konkurruese. Fakti që bisedimet me bavarezët nisin tani do të thotë që mundësia që Robben të mos vazhdojë në "Allianz Arena" është e madhe. Situatën kërkon që ta shfrytëzojë gjiganti turk i Beshiktashit. Ekipi nga Stambolli e pëlqen së tepërmi mesfushorin anësor dhe është gati që të shpenzojë për të. Kontaktet mes palëve kanë nisur, ndërkohë që vetë Robben nuk do të ishte kundër një eksperience të re në kampionatin turk.



I harruar nga Murinjo, por është në radarin e Barcelonës

Luke Shav është në agjendën e Barcelonës, sipas raporteve të së martës në gazetën britanike "Daily Mirror". I margjinalizuar nga Hozë Murinjo te Mançester Junajtedi, Luka Shav, mbrojtësi i majtë, i cili, gjithashtu, mund të luajë edhe në qendër, është një nga lojtarët që ndjek Barcelona, sipas këtij informacioni. Luke Shav, për shkak të margjinalizimit të tij në "Old Trafford", ka refuzuar ta rinovojë kontratën e tij me klubin britanik. 22-vjeçari, me pesë ndeshje ndërkombëtarë me Anglinë, po konsideron një largim nga Mançester Junajtedi dhe mund të përmbushë interesin e Barcelonës. Siç raportohet nga "Daily Mirror", Luka Shav është në agjendën e katalanasve jo vetëm si një opsion, për të luajtur mbrojtës qendror, por edhe si një alternativë për krahun e majtë të mbrojtjes, në të cilin Zhordi Alba është tani si një iniciativë fikse, por francezi Lukas Digne nuk po iu përgjigjet pritshmëri-



ve të krijuara mbi të. Interesi i Barcelonës ka nënkuptuar një frymë për Luke Shav, i cili ëndërron të largohet nga Mançester Junajtedi në muajt e ardhshëm. Arsenali dhe Çellsi, sipas "Daily Mirror", e kanë vënë, gjithashtu, në fokus mbrojtësin 22-vjeçar.



DASHI 21. mars - 20. prill

Sot një pozitivitet i vogël është ajo që duhet, pavarësisht se dashuria dhe aftësia janë të mira dhe nuk ju shkaktojnë probleme. Buzëqeshini jetës dhe gjithçka që keni në të tashmen! Dashuria premtan lindjen e flirteve të reja intriguese për beqarët që duan të bien në dashuri. Jupiteri do të vijë në ndihmë me lajme të mira në fushën profesionale, do të mbusheni me surpriza.



DEMI 21. prill - 21. maj

Hëna përpunon perceptimin tuaj të situatave dhe ju lejon të përballoni shkëlqyeshëm edhe çështjet më të mprehta. Nuk do të keni mosmarrëveshje me partnerin/en. Lajme të bukura afrohen në horizont edhe për zemrat e vetmuara! Një e ardhur shpresë ose promovim do t'ju sjellë fitime emocionuese të reja dhe do t'ju mbush me gëzim!



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Tensione të prodhuara nga dyshja Diell-Saturn në marrëdhënien tuaj dhe keqkuptime me të dashurin/en. Për fat të mirë, mbremja do të përfundojë me ëmbëlsi. Lajme pozitive për beqarët në dashuri, një ditë plot me takime të reja. Jupiteri mbron gjithçka që është e re, prandaj priten edhe investime të reja.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Sot do të keni mjaft energji dhe kjo do t'ju ndihmojë shumë për të reaguar dhe gjithashtu të rifitoni entuziazmin për t'u dashuruar pas disa ditësh të kaluara jo mirë. Beqarët që duan të përfuturojnë emocione të reja do të duhet të shikojnë vetëm përreth! Qjelli po ju ndihmon: për të kapërcyer dyshimet dhe problemet, thjesht zgjeroni horizontet tuaja dhe shikoni më tej.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse jeni të hutuar në anën sentimentale, pasioni do shkojë në vendin e vetë dhe ju do jeni një i/e dashur i pakrahasueshëm. Erosi dhe pasioni sot do të jenë asetet tuaja deri në mëngë, por ato nuk do t'ju japin lumturi! Ka një dëshirë për ndryshim për beqarët, merrni në konsideratë ftesat për takime, yjet ju favorizojnë. Një ditë shumë e kënaqshme nga pikëpamja e biznesit.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Një ditë e qetë për zemrën tuaj, ndjenjat e forta do të vazhdojnë dhe dëshira për projektet në çift do të rriten. Yjet në vend të kësaj ftojnë beqarët të marrin në konsideratë ftesat për takim nëse nuk duan të jenë vetëm. E marta paraqitet e denjë për të mbjellë projekte të rritjes personale dhe profesionale nga të cilat së shpejti do të korni shpërblimet.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Ju jeni nxitur nga një dëshirë e fortë për ndryshim, por Jupiteri sot ju këshillon që të përqendroheni në atë që keni tashmë. Vendorsi ndjenjat dhe qetësinë e çiftit së pari. Zemrat e vetmuara duhet të tregojnë kujdes kur zgjedhin një partner/ejo të besueshëm. Së shpejti do të jeni në gjendje të matni veten në sfida të reja profesionale dhe do të jeni në gjendje të spërkatni ëndrrat e vjetra.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Në dashuri sot ju do të ndjeni nevojën për konfirmime, demonstrata, fakte konkrete. Për fat të mirë për ty ato do të mbërrijnë pa pasur ndoshta nevojën të pyesni! Një ditë me kënaqësi të madhe për beqarët, me Venusin në dashuri gjithçka duket magjike dhe qiellore! Yjet sigurojnë biznes fitimprurës për ata që kanë një profesion të lirë, por edhe ata që punojnë nën varësinë e të tjerëve do të përfitojnë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Jini të kujdesshëm në dashuri dhe në miqësi, mos u nxitoni të besoni në gjithçka. Kërkoni një sqarim nga partneri/ja nëse nuk jeni të sigurt për ndjenjat e tij/saj. Beqarët do të duhet të reflektojnë për pjesëmarrjen aktuale dhe të vlerësojnë nëse ia vlen të vazhdohet. Puna po shkon mirë, edhe nëse dëshironi të ndryshoni, prisni mundësi më të mira.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Ju jeni të hapur për të njohjet e reja dhe shumë Bricjapë sot mund ta përqendrojnë shikimin e tyre në horizontet e tjera. Kur dashuria mbaron ... ktheje faqen! Takime edhe për beqarët, disa prej të cilave mund të jenë fatale dhe themelore për të ardhmen! Do të jeni i qartë dhe i vetëdijshëm për aftësitë tuaja dhe sot diçka mund të ndryshojë patjetër pozicionin tuaj të punës.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Ditë relaksuese dhe e qetë, nëse jeni çift ju do të shijoni momente paqësore dhe rutina e përditshme nuk do t'ju zhgënjëjë aspak. Beqarët do të duhet të presin për dashurinë, diçka mund të lëviz, por kjo nuk është një risi vendimtare. Jini të durueshëm! Mërkuri në kuadraturë krijon tensione në punë dhe midis kolegëve, përpiqui të shmangni problemet.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Lërimi mënjantë thashethemet për diçka që ka të bëjë me jetën tuaj të dashurisë dhe mendoni për mbrojtjen e privatësisë suaj. Për beqarët, vijë takime interesante, nga të cilat mund të lindin marrëveshje të reja. Ditë e rëndësishme në frontin e punës. Për ju sot është përshkruar një rrugë e rëndësishme dhe definitive e rritjes profesionale.

NJOFTIM

BAHRIJE "ANEA" OSEKU — HAXHANELA 15.09.1924 — 16.03.2018

Me dhembje të thellë njoftojmë të afërmit, fafesisin, miqtë dhe dashmirët se ndërroi jetë e dashura jonë. Varrimi i së ndjerës u krye më 23.03.2018 në varrezat e qytetit në Lahr/Schwarzwald, Gjermani.

Të pikëlluarit: Bukurije, Fatmir, Rron dhe Narta Dalladaku.

PËRKUJTIM

BAHRIJE "ANEA" OSEKU — HAXHANELA 15.09.1924 — 16.03.2018

E fortë dhe e qëndrueshme si "Kulla e Sahatit" pranë së cilës jetove. Kujtojmë me mallëngjim fjalët dhe këshillat e Tua të ngrohta, të mençura dhe gjithmonë shpresëdhënëse për një të ardhme më të bukur për të gjithë. Mbetesh shembull i fisnikërisë qytetare shkujpiane. Këshërinjtë nga Shkupi: Kimete dhe Adnan Agai, Teutë Agai—Demjaha, Agon, Dritëro dhe Albesë Demjaha.

	NE KETE DATE	Mensur Mamuti	ELEMENT KIMIK	K	VEPËR E AUTORIT NË FOTO	UNIONI RUSI, FRANCE-BRITANI (1891-1894)
		NËNA, MËMA	AUTORI RUS NË FOTO			
		REGJISORI AMERIKAN, ALDA				
		FUSTANELLË SKOCEZE				
		SHTRESA PREJ LLACI QË I VIHET PËRSËPËR MURIT				
		BESIM (FET)				
		NOTË MUZIKORE				TEMPERATURA
		GAUSI				PRUËSI I MESHIHATIT
		QË I KA DALË KURRIZI SI GUNGË, GUNGORE			RADIUMI	SHTRESË E HOLLË DYLLI

VEPËR E AUTORIT NË FOTO	Z	NDËRTIM MBI UJË	PJESA E KRAHËT NGA BERRYLI DERI TE NYJA E DORËS	ENERGJIA	LË (KRAHIN)	RRATHËT E DJEPT
VESHJE E LESHTË GRASH, LLOJ JELEKU					KËNGËTARJA POLAKE, MONIKA (EUROVISIONI '98)	JO NORMAL
TOKA E PUNUAR				ANKIMI		
NDEZJE FYTI (LAT)				INDUSTRIA KROATE E NAFTAËS		
SPANJA		LLOJ BUALLI AZIATIK			Ë	AZOTI
VEPËR E AUTORIT NË FOTO		PREFIKS PËR "AJRORE"			URËS, DEMIROXHAK	REOMIRI
QYTET NË SHQIPËRI						
F				LISTA E USHQIMEVE		KRUNA
				MELIHATE AJETI		MIHAL STEFA
KOHA	KRYEMINISTRI, EDI				LLOJ BIME, I HAHEN RRËNJËT	
QË NUK I PËRKET TEORISË HALAKISTE (TURAT)	JODI				ANGSTREMI	

ZGJIDHJET: K, MAMA, ALAN, KILT, SUVA, IMAN, MI, T, G, RA, Z, GOFE, GUPE, URLIK, ARA, ANKESA, LARINGITIS, E, ANOA, E, N, MAKAR ÇUDRA, FIER, FIEN, MENY, K, RAMA, ALLMË, JO HALAKIST.

Çokollata "shkencore", 30 për qind më pak sheqer



Kompania Nestle pretendon se është e para në botë që ka ristrukturuar sheqerin që përdor në ëmbëlsirat e saj, për të prodhuar një çokollatë me 30% më pak sheqer. Nestle është prodhuesi më i madh në botë i ushqimeve të paketuara,

por sheqeri i ristrukturuar po prodhohet në fabrikën e saj në Dalston (Britani), si pasojë e presionit të qeverisë britanike ndaj kompanive ushqimore që të reduktojnë sheqerin në produktet e tyre, për të ndihmuar në reduktimin e obezitetit tek

fëmijët. Në këtë kuadër, kompanitë e çokollatave dhe ëmbëlsirave kanë një detyrë titanike, pasi sheqeri është themelor në produktet e tyre. Por, kompania Nestle thotë se ka shfrytëzuar shkencën për të reduktuar sheqerin. Ky i fundit në çokollatat e reja Milkybar Wowsomes, është amorf dhe poroz. Ai krijohet duke sprucuar sheqer, qumësht dhe ujë në një ambient me ajër të ngrohtë dhe më pas e gjithë kjo përzierje thahet. Sheqeri i ri teknologjik nuk është më i ngjeshur si ai i zakonshmi dhe tretet shumë shpejt. Ndërsa arritja e Nestle është përshëndetur, kritikët thonë se nuk duhet kuzifuar vetëm për Britaninë. Kjo e fundit po i nxit kompanitë e ushqimit që deri në 2020 sheqeri në pruduakte të jetë ulur me 20% dhe shpreson që shembulli i Nestle të ndiqet nga të tjerë.



Ëmbëlsira perfekte? Akullorja me flori

Nëse kërkon të provoni ëmbëlsirën ideale, duhet të shkoni në Amerikë. Në Snowopolis të Anahajmit (Kaliforni) shërbehet një akullorë me flori 24 karat. Me një çmim prej 15 dollarësh, kjo akullorë me vanilje mund të konsumohet e gjitha, përfshi floririn. Kjo akullorë është bërë e famshme pasi motrat Kardashian e postuan në rrjetet e tyre sociale. Sa për shijen, ata që e kanë provuar thonë se floriri e plotëson më së miri vaniljen dhe shtojë se mund të hahet pa merak. Fillimisht, kjo akullorë ishte menduar të ishte e disponueshme vetëm për një kohë të caktuar, por, duke marrë parasysh kërkesat e shumta për të, u mbajt në menu.

Viagra "mbush" 20 vjeç, 65 milionë receta në botë

Viagra ka "mbushur" sot 20 vjeç. Më 27 mars, 1998 Food and Drug Administration e SHBA (FDA), e cila është agjencia amerikane përgjegjëse për rregullimin e tregut farmaceutik dhe ushqimor, dha dritën e gjelbër për krijimin e pilulës së vogël blu. Ky ishte starti për një revolucion seksi, pasi ajo ka lejuar miliona njerëz të kthehen në marrëdhëniet seksuale dhe ka nxjerrë në pah në bisedat e përditshme temën e impotencës, deri atëherë tabu. Zbulimi i Viagres ishte i rastësishëm, pasi në fillim të viteve 1990 disa ekupe Pfizer po eksperimentonin me një ilaç të ri të quajtur Sildenafil kundër hipertensionit dhe angines; Ajo nuk u tregua e dobishme për të qetësuar dhimbjen e krahorit, por kishte një efekt anësor të papritur tek burrat, dmth. Ngritje të penisit. Shumica e vullnetarëve meshkuj që morën pjesë në eksperimente gjithashtu raportuan një përmirësim të ndjeshëm në jetën e tyre seksuale. Në atë pikë, Pfizer filloi të përqendrohet në impotencën mashkullore, një problem që prek një të tretën e meshkujve mbi 40 vjeç. Suksesi i Viagras ishte i menjëhershëm: 150 mijë receta u



shkruan në SHBA vetëm në dy javët e para kur medikamenti ishte vënë në shitje. Dhe madje edhe para se të mbërrinte në farmacitë e vendeve të tjera, ajo arriti në tregun e zi në Izrael, Poloni dhe Arabinë Saudite me çmime pesë herë më të larta se kostoja ligjore në SHBA. Pas nisjes zyrtare në Evropë, në shtator të vitit 1998, pilula blu u bë për Pfizer një burim i rëndësishëm i të ardhurave, dhe për të rritur famën e saj ishin fushatat e kandidatit presidencial Use Bob Dole në vitin 1999 dhe Legjenda e futbollit Pele në vitin 2002. Rreth 65 milionë receta Viagra janë bërë në botë dhe marketingu i saj përkon me ardhjen e internetit dhe shpërthimin e pornografisë në internet. Me këtë pilulë ka ndryshuar edhe fjalori i marketingut.



Populistët Di Maio e Salvini "puthen" në Romë

Një murale me imazhin e Luigi Di Maio, kandidatin për kryeministër nga Lëvizja "5 Yjet", që puthet me rivalin e tij nga Lega Nord, Matteo Salvini është realizuar në Via del Collegio Capranica, në qendër të Romës. Pas disa orësh piktura

është "censuruar", pasi i janë vendosur për ta mbuluar mbeturinat e kutive të kartonit. Pak më larg, nga i njëjti artist, artisti i rrugës Tv-Boy, është një tjetër mural me Giorgia Melonin, që mban në krah një fëmijë me ngjyrë.



193 - Perandori romak vritet nga Garda pretoriane, të cilët pastaj she-sin fronin në ankand Didius Julianit.

1556 - I biri i Karlit V, Filipi II kurorëzohet mbret i Spanjës.

1738 - Parlamenti anglez i shpall luftë Spanjës.

1799 - Shteti i Nju Jorkut shfuqizon robërinë.

1845 - Meksiko ndërpret marrëdhëniet diplomatike me SHBA

1920 - Thomas Masaryk zgjidhet kryetar i Çekosllovakisë

1930 - Konstantinopoja dhe Angora i ndërrojnë emrat në Stamboll dhe Ankara.

1969 - Poeti grek dhe fituesi i Çmimit Nobel Giorgos Seferis bën një fjalim të famshëm në BBC duke kundërshtuar juntën në Greqi.

1993 - Konservativët fitojnë zgjedhjet parlamentare në Francë

Franklin D. Roosevelt është i vetmi President i SHBA-ve që ishte President më shumë se 8 vjet dhe njëri nga më me ndikimin të madh në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Një zemër normale ka të rrahurat 72 herë në minutë! Kjo do të thotë që 100.000 herë në ditë, apo 3.600.000 në vit! Zemra e gjinisë femërore është 25% më e vogël se ajo e gjinisë mashkullore.



E-mailët spam konsumojnë 33miliard KWh energji elektrike brenda një viti, energji kjo e cila do të mjaftonte për të furnizuar plot 2.4 milionë shtëpi.




DITARI I NJË GRUAJE

Në ditarin e një gruaje që kishte udhëtuar me anije shkruante...
- E Martë, është dita e tretë e udhëtimit në anije. Sot mu afrua kapiteni i anijes dhe po më vardiset...
- E Mërkurë, kapiteni i anijes më ftoi për drek në kabinën e tij...
- E Enjte, kapiteni i anijes kërkoi që ta kalojë natën me mua...
- E Premte, kapiteni i anijes m'u kërcënua se nëse nuk pranoj të fle me të do ta fundosi anijen me gjithë 387 pasagjerët...
- E Shtunë, i shpëtova 387 pasagjerët nga anija jonë!



Mosha nuk ka rëndësi, nëse nuk je djathë.
(Billie Burke)

KALENDARI HISTORIK 28 MARS



A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS